# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5774
E shtunë, 11 maj 2019
çmimi 0.40 €

Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"


## Ndryshimi i Ligjit për financimin e partive ‘përplas’ opozitën

FAQE 3



AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", ENVER HOXHAJ FAQE 4-5

# Samiti i Parisit presim të sjellë qartësi të plotë për dialogun



Zëvendëskryeministri i Kosovës, Enver Hoxhaj, ka bërë me dije se platforma e miratuar në Kuvend është korniza e vetme politike e cila duhet ta kornizojë mendimin dhe veprimin politik të Kosovës në takimin e Parisit. Ai ka thënë se shteti i Kosovës pret nga Samiti i Parisit qartësi të plotë për vazhdimin e dialogut me Serbinë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Hoxhaj ka deklaruar se dialogu Kosovë - Serbi nuk mund të përmbyllet me një rezultat pozitiv për Kosovën pa mbështetjen e thellë amerikane. Ai ka thënë se një mbështetje dhe një angazhim amerikan është kyç për këtë proces. Sipas Hoxhajt, letra e presidentit Trump dërguar presidentit të Kosovës dhe presidentit të Serbisë është kornizë dhe substanca e këtij procesi dialogues. Ai ka rikujtuar se kanë qenë pikërisht amerikanët të cilët i kanë mbyllur të gjitha marrëveshjet në Ballkan

## AKTUALE

### ‘LIDERËT’ SHQIPTARË DHE TRI GJËRAT E ‘MËDHA’ TË TYRE F.11



Nga Jakup KRASNIQI

### MJEKU NGA AUSTRALIA OPERON 30 FËMIJË ME PROBLEME KIRURGJIKE F. 7

### SHËNOHET 92-VJETORI I SHKOLLËS FILLORE "MAXHUN ÇEKAJ", VENDKOMANDË E UÇK-së F. 6

### LOREDANA ZEFI: PARATË NUK U MORËN ME MASHTRIME, POR ME VULLNET TË PALËS TJETËR F. 7



# Mbi 800 armë në procedurë të legalizimit




Zëvendësministri i Punëve të Brendshme dhe Koordinatori Kombëtar për Kontrollin e Armëve të Vogla dhe të Lehta (AVL), Izmi Zeka, u ka bërë thirrje qytetarëve ta shfrytëzojnë mundësinë për legalizimin e armëve të kategorizuara B, C dhe D, që në mënyrë të drejtpërdrejtë do të kontribuojnë në ngritjen e sigurisë në bashkësi dhe sigurisë publike në përgjithësi. Ai ka bërë me dije se për gjashtë muaj janë mbi 800 armë në procedurë të legalizimit FAQE 7



## 25 policë të Kosovës trajnohen nga FBI-ja

FAQE 6

## EKONOMI

### HYN NË FUQI LIGJI PËR NDALIMIN E LOJËRAVE TË FATIT F. 9

### LANSOHET UEBFAQJA PËR RAPORTIMIN E PRODUKTEVE TË RREZIKSHME F. 9

## SPORT

### FITORJA, OPSION I VETËM PËR PRISHTINËN DHE LLAPIN F. 18

RENOVA PUTZ
Maqedoni Xhepçisht –Tetovë Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009 +389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan , Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

## Sot i jepet lamtumira e fundit nëntetares Zarife Hasanaj



TIRANË, 10 MAJ - Sot (e shtunë) në orën 10:00 deri në 11:30 do të mbahen homazhet në nderim të nëntetares Zarife Hasanaj. Ndërsa në orën 13:00 do të mbahet ceremonia e varrimit pranë varrezave "Dëshmoret e Kombit". Zarife Hasanaj është shpallur "Dëshmor i atdheut", pasi humbi jetën në krye të detyrës.
Përpara se trupi i saj të nisej drejt Shqipërisë, në bazën Camp Adazi, në Letoni është zhvilluar një ceremoni lamtumire me pjesëmarrjen e dhjetë vendeve, pjesë e misionit "Enhanced Forward Presence".

# Protesta e opozitës, ShBA-ja kërkon që të shmanget dhuna

Ambasada Amerikane në Tiranë në deklaratën e saj u ka bërë thirrje mbështetësve të opozitës, në protestën e thirrur për sot (e shtunë) prej saj në Tiranë, që ta refuzojnë dhunën për të siguruar një protestë paqësore dhe konstruktive




TIRANË, 10 MAJ - Ambasada e Shteteve të Bashkuara në Tiranë u bëri të premten thirrje mbështetësve të opozitës, në protestën e thirrur për sot (e shtunë) prej saj në Tiranë, që të refuzojnë dhunën për të siguruar një protestë paqësore dhe konstruktive.
Protesta e sotme e opozitës është e 12-ta që prej muajit shkurt kur ajo u largua nga parlamenti duke hequr dorë nga mandatet e deputetëve të saj. Shpesh në protestat e organizuara në Tiranë janë regjistruar përplasje të dhunshme me policinë e cila ka përdorur dhe gazin lotsjellës për t'i shpërndarë manifestuesit.
Në deklaratën e saj Ambasada amerikane thekson se "përgjatë muajve të fundit, pjesa më e madhe e pjesëmarrësve kanë ushtruar të drejtën e tyre për të protestuar paqësisht. Megjithatë, në çastin kur një protestë paqësore njolloset nga një akt dhune, qoftë edhe nga një individ, qëllimi demokratik i protestës komprometohet. Është e paligjshme dhe jodemokratike të kryesh akte dhune, përfshirë edhe shkatërrimin e pronës", thuhet tutje në deklaratë.
Opozita kërkon dorëheqjen e kryeministrit Edi Rama dhe krijimin e një qeverie kalimtare që të përgatisë zgjedhje të parakohshme, ndërsa ka paralajmëruar se nuk do të lejojë organizimin e zgjedhjeve vendore të 30 qershorit. Nga ana e saj shumica ka përsëritur se nuk do të ketë shtyrje të zgjedhjeve vendore dhe se ato do mbahen në datën e caktuar.
Bëhet e ditur se degët e PD-së dhe LSI-së në rrethe kanë organizuar mbështetësit, të cilët do të udhëtojnë prej qyteteve të tyre për t'u bashkuar në kryeqytet në orën 18:30 kur dhe do të nisë tubimi para Kryeministrisë.
Policia mësohet se ka angazhuar mbi 1200 efektivë që do të jenë në gatishmëri si para godinës së qeverisë ashtu dhe pranë institucioneve të tjera shtetërore.
Në mbështetje të tyre do të jenë dhe mjetet ujëhedhëse, ashtu si dhe ka ndodhur në tubimet e shkuara.
Lideri opozitar, Lulzim Basha ftoi edhe socialistët të dalin ne shesh ndërsa lajmëroi se protestës do t'i bashkohen 300 studentët evropianë, të organizatës studentore të Partisë Popullore Evropiane. "Kjo është një betejë kombëtare, por është edhe një betejë evropiane", tha Basha.

# Hungaria kërkon nga BE-ja t'i nisë negociatat me Shqipërinë në qershor



TIRANË, 10 MAJ - Ministri në detyrë për Evropën dhe Punët e Jashtme, Gent Cakaj, me ftesë të ministrit të Punëve të Jashtme dhe të Tregtisë të Hungarisë, Peter Szijjarto, ka zhvilluar një vizitë zyrtare në Budapest.
Gjatë konferencës së përbashkët ministri i Jashtëm i Hungarisë, ka thënë se Bashkimi Evropian duhet t'i hapë negociatat me Shqipërinë në muajin qershor. Ai ka theksuar se "do të ishte e papranueshme shtyrja e vendimit për çeljen e negociatave të Shqipërisë me BE-në".
Gjatë takimit ministri Szijjarto ka theksuar se "siguria dhe stabiliteti i Ballkanit Perëndimor është i rëndësishëm si dhe ndikon drejtpërdrejt edhe në sigurinë e Evropës Qendrore".
Ndërkohë, ministri në detyrë për Evropën dhe Punët e Jashtme të Shqipërisë, Gent Cakaj, ka deklaruar se "Shqipëria mbetet shpresëplotë për hapjen e negociatave, kjo bazuar në rezultatet e arritur deri më sot nga zbatimi i reformës në drejtësi e deri te reforma në administratën publike". "Këshilli do të vendosë pozitivisht për hapjen e negociatave për anëtarësim në muajin qershor", ka theksuar Cakaj.
Të dy ministrat kanë ndarë vlerësimin për marrëdhëniet shumë të mira në mes të dy vendeve si në aspektin politik, por edhe në atë ekonomik.

# Vasfije Krasniqi-Goodman, fituese e çmimit të paqes Kim Bok-dong




PRISHTINË, 10 MAJ - Aktivistja e Qendrës Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës (QKRMT), Vasfije Krasniqi Goodman, e cila avokon për të mbijetuarit e dhunës seksuale në nivel global, është fituese e çmimit Kim Bokdong për paqe.
Këshilli korean për Drejtësinë dhe Përkujtimin për Çështjen e Skllavërisë Seksuale Ushtarake nga Japonia ka zgjedhur të mbijetuarën e Kosovës, Vasfije Krasniqi-Goodman, fituese të çmimit të paqes Kim Bok-dong për vitin 2019.
Ky çmim nderon individët apo organizatat që kanë qenë të angazhuar në lëvizje për ta zgjidhur çështjen e dhunës seksuale gjatë luftës dhe për t'i siguruar të drejtat e njeriut të grave në konfliktet e armatosura anembanë botës.
Vasfije Krasniqi-Goodman është viktima e parë që ka treguar publikisht historinë dhe traumën e saj të dhunës seksuale që kishte përjetuar gjatë luftës në Kosovë. Më pastaj ajo u bë zë i fuqishëm i fushatës 'Bëhu zëri im' në mbështetje të të mbijetuarve të dhunës seksuale gjatë luftës dhe përpjekjet e palodhshme të saj për luftimin e stigmatizimit që rrethon këtë kategori shoqërore.

## Krimineli Lazareviq udhëheq paradën ushtarake të Serbisë



BEOGRAD, 10 MAJ - Parada ushtarake e Serbisë që është mbajtur të premten në Nish është udhëhequr nga gjenerali serb Vladimir Lazareviq, ish-komandant i Armatës së Tretë që ka vepruar gjatë kohës së ish-Jugosllavisë në Prishtinë.
Lazareviqi është dënuar nga Tribunali i Hagës me 14 vjet për krime kundër njerëzimit, për shkelje të ligjeve dhe zakoneve të luftës dhe për krime ndaj njerëzimit.
I dënuari për krime lufte, Vladimir Lazareviq në fjalën e tij gjatë kësaj parade ka thurur lavde për triumfin e Serbisë kundër shteteve që sipas tij tani e kanë krijuar paktin e NATO-s.
Kjo gjë nuk i ka pëlqyer aspak ambasadorit të ShBA-së në Serbi, Kyle Scott.
Scott ka reaguar ashpër ndaj këtij vendimi të autoriteteve serbe duke e quajtur edhe vendim të turpshëm. "Është një turp që një i dënuar për krime lufte të marshoj përpara atyre të cilët tregojnë respekt ndaj aleatëve të cilët vdiqën duke luftuar për paqe dhe drejtësi në Evropë. Dita e Evropës - Vlerat Evropiane", ka shkruar Scott në profilin e tij zyrtar në "Twitter".

EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

Komisioni për Integrime Evropiane ka miratuar Projektligjin për ndryshimin e Ligjit për financimin e subjekteve politike

# Ndryshimi i Ligjit për financimin e partive 'përplas' opozitën

**Propozimi i Partisë Socialdemokrate (PSD), që Ligji për financimin e partive politike të ndryshohet në atë që grupet parlamentare ta gëzojnë të drejtën e financimit nga Fondi për Demokratizim, ka bërë që Lidhja Demokratike e Kosovës dhe Lëvizja Vetëvendosje të jenë kundër Projektligjit për ndryshimin e Ligjit për financimin e subjekteve politike, i cili është miratuar të premten nga Komisioni për Integrime Evropiane**

EPOKA E RE Muhamet KOCI

PRISHTINË, 10 MAJ - Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dhe Lëvizja Vetëvendosje (LV) kanë kundërshtuar Projektligjin për ndryshimin e ligjit për financimin e subjekteve politike, të cilin Komisioni për Integrime Evropiane e ka miratuar të premten. Këto dy subjekte opozitare nuk janë pajtuar me propozimin e Partisë Socialdemokrate (PSD) që Ligji për financimin e partive politike të ndryshohet në atë që grupet parlamentare ta gëzojnë të drejtën e financimit nga Fondi për Demokratizim.

Fillimisht kryetarja e Komisionit, Blerta Deliu-Kodra, ka sqaruar se fushëveprimtaria e këtij projektligji nuk rregullohet në mënyrë specifike me legjislacion të BE-së, rrjedhimisht as amendamentet e komisionit funksional, ndërkaq ka shtuar se ndryshimet për rregullimin e çështjes së financimit të subjekteve politike janë kërkuar nga BE-ja dhe nga raportet për vendin.

Deputetja e Lëvizja Vetëvendosje në këtë komision, Fatmire Kollçaku, ka propozuar që projektligji të mos hidhet në votim, por të kërkohet mendimi i ri në Komisionin e Venecias. "Ne propozojmë që ky projektligj të mos hidhet në votim, por t'i kthehet për mendim, me kërkesë të kryeparlamentarit, për një mendim të ri te Komisionit të Venecias, që të jemi në rregull. Tashmë me të gjitha amendamentet dhe ndryshimet nuk është i njëjti. Apo eventualisht që ky draft t'i kthehet Komisionit Ad-hoc që është në kuadër të reformës zgjedhore sepse, si i tillë, është i papranueshëm të votohet", ka thënë ajo.

Sipas Kollçakut, moskrijimi i Zyrës për Regjistrim dhe Certifikim të partive politike në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve ka ardhur si vërejtje edhe nga Zyra e Bashkimit Evropian në Prishtinë. "Si i tillë, është i papranueshëm të votohet. Edhe zyra e BE-së ka pasur vërejtje, pasi që është miratuar në komisionin funksional për shkak të një zyre e cila tashmë nuk parashihet në kuadër të KQZ-së. Prandaj, përshirë të gjitha këto vërejtje, nuk do të marrim pjesë në votim të këtij projektligji", ka thënë Kollçaku, duke e lëshuar mbledhjen.

Deputeti i LDK-së, Armend Zemaj, ka thënë se përmes këtij projektligji po tentohet të bëhen pazare. "Lidhja Demokratike e Kosovës e ka potencuar shpesh që kjo mund të kalojë jo vetëm në atë që quhet në gjuhën pak më të drejtpërdrejtë, pazare, por krijon mundësinë që deputetët, përtej pavarësisë, të krijojnë situata që për nevoja financiare ta hupin edhe imazhin dhe mundësinë e kualitetit, qoftë të ligjeve apo qoftë të vendimmarrjes në Kuvendin e Kosovës", ka thënë Zemaj.

Pretendimet e këtyre dy partive i ka kundërshtuar deputeti i PSD-së, Visar Ymeri, i cili ka thënë se Kushtetuta e njeh lirinë e deputetit dhe përcaktimin e tij të lirë jo vetëm për votë, por edhe për qëndrime politike e grupime politike brenda Kuvendit të Kosovës.

Ai ka thënë se sipas kësaj fryme të Kushtetutës duhet edhe ligjet e tjera të nxirren në vijë me këtë. "Ne nëse sot e kemi me të gjitha ligjet mundësinë e krijimit të një grupi parlamentar nga jo më pak se gjashtë deputetë, mundësia e krijimit të grupit parlamentar do të duhej të përcillet pastaj me përgjegjësitë të cilat mbështeten karshi një grupi parlamentar që i gëzojnë të tjerat grupe në Kuvend. Në përputhje me këtë, kemi propozuar që edhe Ligji për financimin e partive politike të ndryshohet në atë, që gupet parlamentare ta gëzojnë të drejtën e financimit nga Fondi për Demokratizim. Konsiderojmë se një e drejtë e tillë e mundëson demokratizimin e vendit", ka thënë Ymeri.

Ndryshimin e ligjit aktual e ka përkrahur edhe PDK-ja. Deputeti i këtij subjekti politik, Zenun Pajaziti, ka thënë se propozimi i PSD-së është i mirëseardhur. "Mirë që ka ndodhur kjo nismë, sepse është një realitet krejt i ri. Ndryshimet e tilla i bëjnë mirë profilizimit të skenës politike në Kosovë. Nismat e tilla do të ndihmojnë të këtë edhe demokraci të brendshme", ka thënë Pajaziti.

Në bazë të Ligjit për financimin e subjekteve politike, partitë janë të obliguara që të publikojnë për çdo vit raportin vjetor financiar, që tregon të gjitha të hyrat dhe shpenzimet e partisë. Mirëpo, përveç Lëvizjes Vetëvendosje, partitë e tjera nuk e kanë të publikuar as raportin financiar për fushatën e zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 2017.



## Afati i aplikimit për akreditimin e vëzhguesve për zgjedhjet në veri deri më 12 maj

PRISHTINË, 10 MAJ (ER) - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka njoftuar se nga 9 prilli ka filluar afati për dorëzimin e kërkesave për akreditim të vëzhguesve për zgjedhjet e jashtëzakonshme për kryetar të Komunës së Mitrovicës së Veriut, Zubin Potokut, Leposaviqit dhe Zveçanit, të cilat do të mbahen më 19 maj.

Sipas vendimit të KQZ-së, ky afat përfundon më 12 maj në orën 18:00.

Kërkesën për t'u akredituar për vëzhgimin e zgjedhjeve duhet ta dorëzojnë subjektet politike të certifikuara, OJQ-të, organizatat qeveritare dhe ndërqeveritare, organizatat ndërkombëtare të specializuara të cilat merren me zgjedhjet dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, përfaqësuesit e vendeve të huaja si dhe mediet.

Vetëm vëzhguesit e akredituar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve mund t'i vëzhgojnë këto zgjedhje.



Flet për "Epokën e re", Enver Hoxhaj

# Samiti i Parisit presim të sjellë



**Zëvendëskryeministri i Kosovës, Enver Hoxhaj, ka bërë me dije se platforma e miratuar në Kuvend është korniza e vetme politike e cila duhet ta kornizojë mendimin dhe veprimin politik të Kosovës në takimin e Parisit. Ai ka thënë se shteti i Kosovës pret nga Samiti i Parisit qartësi të plotë për vazhdimin e dialogut me Serbinë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Hoxhaj ka deklaruar se dialogu Kosovë - Serbi nuk mund të përmbyllet me një rezultat pozitiv për Kosovën pa mbështetjen e thellë amerikane. Ai ka thënë se një mbështetje dhe një angazhim amerikan është kyç për këtë proces. Sipas Hoxhajt, letra e presidentit Trump dërguar presidentit të Kosovës dhe presidentit të Serbisë është kornizë dhe substanca e këtij procesi dialogues. Ai ka rikujtuar se kanë qenë pikërisht amerikanët të cilët i kanë mbyllur të gjitha marrëveshjet në Ballkan**

EPOKA E RE Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 10 MAJ - Zëvendëskryeministri Enver Hoxhaj ka thënë të premten se shteti i Kosovës pret nga Samiti i Parisit qartësi të plotë për vazhdimin e dialogut me Serbinë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se partnerët amerikanë dhe evropianë duhet të jenë të një mendje sa i takon dialogut. "Ne presim që në Samitin e Parisit të ketë qëllime të qarta, parametra për vazhdimin e dialogut shumë më të qarta dhe pritjet që kanë të bëjnë me zbatimin e marrëveshjeve të jenë më të qarta, meqë takimi në Paris është biletaral Kosovë - Serbi, natyrisht me pjesëmarrje të Francës dhe Gjermanisë dhe institucioneve të tjera të BE-së, përderisa Samiti i Berlinit ka qenë një samit ku Kosova ka qenë tema kryesore, por jo e vetme, pra ka pasur edhe tema të tjera rajonale. Pritjet tona janë që të ketë qartësi të plotë rreth vazhdimit të dialogut dhe rreth dinamikës së dialogut. Por ende ka kohë, sepse janë edhe disa javë në dispozicion", ka deklaruar Hoxhaj.

Ai ka thënë se platforma e miratuar në Kuvend është korniza e vetme politike e cila duhet ta kornizojë mendimin dhe veprimin politik të Kosovës në takimin e Parisit. "Qëllimet tona janë ato të cilat i kemi përcaktuar me platformën e miratuar në Kuvendin e Kosovës. Platforma është korniza e vetme politike e cila duhet ta kornizojë mendimin dhe veprimin politik të Kosovës në takimin e Parisit dhe në çdo takim sa herë që kemi të bëjmë me dialogun, sepse dialogu për ne është proces i njëjtë, pavarësisht se ku zhvillohen takimet", është shprehur Hoxhaj.

Zëvendëskryeministri Enver Hoxhaj ka deklaruar se dialogu Kosovë - Serbi nuk mund të përmbyllet me një rezultat pozitiv për Kosovën pa mbështetjen e thellë amerikane. Ai ka thënë se një mbështetje dhe një angazhim amerikan është kyç në këtë proces. Sipas Hoxhajt, letra e presidentit Trump dërguar presidentit të Kosovës dhe presidentit të Serbisë është kornizë dhe substanca e këtij procesi dialogues. "Kanë qenë amerikanët të cilët i kanë mbyllur të gjitha marrëveshjet në Ballkan. Përmbyllja e shtetndërtimit të Kosovës përmes kësaj marrëveshje po ashtu mund dhe duhet të përcaktohet nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, natyrisht në koordinim me Bashkimin Evropian. Një mbështetje dhe një angazhim amerikan është kyç dhe letra e presidentit Trump e dërguar te presidenti i Kosovës dhe presidenti i Serbisë është korniza dhe substanca e këtij procesi", ka theksuar Hoxhaj.

**"Epoka e re":** *Z. Hoxhaj, cilat janë pritjet e shtetit të Kosovës nga Samiti i Parisit që do të mbahet më 1 korrik?*

**Hoxhaj:** Ne presim që në Samitin e Parisit të ketë qëllime të qarta, parametra për vazhdimin e dialogut shumë më të qarta dhe pritjet që kanë të bëjnë me zbatimin e marrëveshjeve të jenë më të qarta, meqë takimi në Paris është biletaral Kosovë - Serbi, natyrisht me pjesëmarrje të Francës dhe Gjermanisë dhe institucioneve të tjera të BE-së, përderisa Samiti i Berlinit ka qenë një samit ku Kosova ka qenë tema kryesore, por jo e vetme, pra ka pasur edhe tema të tjera rajonale. Pritjet tona janë që të ketë qartësi të plotë

# qartësi të plotë për dialogun



rreth vazhdimit të dialogut dhe rreth dinamikës së dialogut. Por, ende ka kohë, sepse janë edhe disa javë në dispozicion.

**"Epoka e re":** *Për dallim nga Berlini, jeni optimist se Parisi do të sjellë diçka konkrete?*
**Hoxhaj:** Samiti i Berlinit ka qenë një ngjarje shumë e rëndësishme meqë është rikthyer vëmendja e dy shteteve më të fuqishme evropiane, Gjermanisë dhe Francës, në raport me Ballkanin Perëndimor. Por karakteri i samitit ka qenë multilateral, kanë qenë të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor dhe pritjet e samitit kanë pasur të bëjnë me tema konkrete sikurse dialogu Kosovë - Serbi dhe raportet e tjera bilaterale në mes të dy vendeve. Ka pasur të bëjë edhe me të ardhmen e rajonit, qoftë hapja e negociatave për Shqipërinë dhe Maqedoninë, qoftë mbyllja e kapitujve të caktuar sa i takon Malit të Zi dhe Serbisë, qoftë edhe situata në Bosnje. Ndërsa Samiti i Parisit ka karakter krejt tjetër dhe pritet të shihet se si do të duket dialogu gjatë fazës së ardhshme. Për neve është shumë me rëndësi që të ketë koordinim jo vetëm brenda përbrenda Kosovës, por të ketë koordinim edhe në mes të partnerëve perëndimorë. Duam që t'i shohim partnerët tanë amerikanë dhe partnerët tanë evropianë që janë të një mendje sa i takon dialogut dhe duhet të ketë koordinim edhe në mes shteteve kyçe të perëndimit, sepse në një proces të tillë do të duhej të ballafaqohemi me Rusinë dhe ballafaqimi me Rusinë mund të jetë vetëm nëse Perëndimi është unik rreth pritjeve të rezultateve të dialogut.

**"Epoka e re":** *Sa ka gjasë që në këtë samit të prezantohet ndonjë plan për marrëveshjen Kosovë - Serbi?*
**Hoxhaj:** Është ende herët dhe nuk dua të spekuloj. Shpresoj se ambasadorët e vendeve gjegjëse, Francës dhe Gjermanisë apo znj. Mogherini, apo edhe vendet e Quintit të dalin me një qartësi para se të ndodhë ky takim. Por, përtej kësaj se çfarë mund të ofrojnë shtetet perëndimore jam i mendimit se ne si Kosovë duhet ta kemi një qartësi të plotë se pse shkojmë në Paris? Cilat janë qëllimet tona në Paris? Dhe cilat janë pritjet tona në Paris? Dhe kjo duhet të komunikohet me partnerët tanë perëndimorë. Këtu duhet të ketë koordinim dhe mendim strategjik nga ana e Kosovës si do të ecim përpara.

**"Epoka e re":** *Cilat janë objektivat e Kosovës për këtë samit?*
Hoxhaj: Qëllimet tona janë ato të cilat i kemi përcaktuar me platformën e miratuar në Kuvendin e Kosovës. Platforma është korniza e vetme politike e cila duhet ta kornizojë mendimin dhe veprimin politik të Kosovës në takimin e Parisit dhe në çdo takim sa herë që kemi të bëjmë me dialogun sepse dialogu për ne është proces i njëjtë, pavarësisht se ku zhvillohen takimet.

**"Epoka e re":** *Mund të arrihet një marrëveshje ndërmjet dy vendeve me ndërmjetësimin e Evropës, apo pa Shtetet e Bashkuara të Amerikës nuk do të mund të arrihet një gjë e tillë?*
**Hoxhaj:** Dialogu zhvillohet në Bruksel dhe Brukseli është platformë e normalizimit të raporteve Kosovë - Serbi. Bashkimi Evropian, pas rezolutës së miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Këshillit të Sigurimit në shtator të vitit 2010, është ngarkuar që ta fasilitojë dialogun, por tema e Kosovës në raport me Serbinë është e natyrës globale dhe kjo mund të mbyllet vetëm në Këshill të Sigurimit. Marrëveshja që nënshkruan Kosova dhe Serbia mund të jetë e përhershme dhe përfundimtare vetëm nëse e votojnë shtetet anëtare të Këshillit të Sigurimit. Prandaj, dialogu Kosovë - Serbi nuk mund të përmbyllet me një rezultat pozitiv për Kosovën pa mbështetjen e thellë amerikane. Kanë qenë amerikanët të cilët i kanë mbyllur të gjitha marrëveshjet në Ballkan. Përmbyllja e shtetndërtimit të Kosovës përmes kësaj marrëveshje, po ashtu mund dhe duhet të përcaktohet nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, natyrisht në koordinim me Bashkimin Evropian. Një mbështetje dhe një angazhim amerikan është kyç dhe letra e presidentit Trump e dërguar te presidenti i Kosovës dhe presidenti i Serbisë është kornizë dhe substanca e këtij procesi.

**"Epoka e re":** *Si e shihni dialogun Kosovë - Serbi pas Samitit të Parisit?*
**Hoxhaj:** Aktualisht dialogu është në ngërç. Dialogu është temë e vdekur. Si Kosovë duhet të mendojmë se cilat janë interesat tona strategjike. E di se në opinion publik qytetarët e Kosovës nuk e shohin si popullor temën e dialogut, por mendoj se ne si institucione të Kosovës kemi mandat për ta përmbyllur këtë temë dhe ta anëtarësojmë Kosovën në OKB. Do të varet shumë prej takimit në Paris se si mund të vazhdohet përpara, por aktualisht dialogut është në ngërç.

**"Epoka e re":** *Z. Hoxhaj, pas përfundimit të zgjedhjeve të brendshme, a prisni një qasje të re të Bashkimit Evropian për Ballkanin Perëndimor në përgjithësi, edhe për Kosovë dhe dialogun me Serbi në veçanti?*
**Hoxhaj**: Pas zgjedhjeve nga Bashkimi Evropian pres një qartësi për vizat dhe një vendimmarrje në qershor për vizat. Kjo do ta rriste kredibilitetin e BE-së në sytë e qytetarëve të Kosovës edhe të lidershipit. Sa i përket dialogut jemi të përkushtuar që ky proces të vazhdojë dhe besoj se do të ketë koordinim në mes të institucioneve të BE-së dhe shteteve kyçe të BE-së se si të vazhdohet më tutje.

## MPB-ja: Tenderi për furnizim me certifikata të gjendjes civile është në fazën e vlerësimit

**Prishtinë, 10 maj (ER)** - Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) ka njoftuar qytetarët e Republikës së Kosovës se tenderi për furnizim me certifikata të gjendjes civile është në fazën e vlerësimit dhe se aktualisht shërbimet e gjendjes civile janë duke u kryer përmes dokumenteve të shtypura në letër të bardhë, por që përmbajnë nënshkrimin e zyrtarit të autorizuar dhe vulën. "Gjithashtu ju njoftojmë se në janar të vitit 2019 kemi pasur një furnizim prej 600 000 certifikatash por, për shkak të numrit të madh të kërkesave, ato janë shpenzuar brenda një afati të shkurtër kohor. Këto shërbime kryhen nga të gjitha zyrat e gjendjes civile nëpër të gjitha komunat dhe nuk ka nevojë për shqetësim. Po ashtu, pajisja e qytetarëve me letërnjoftim është duke u bërë brenda afatit ligjor 15 ditor", është thënë në njoftimin e MPB-së.

Kjo ministri ka theksuar se, sipas Ligjit për Letërnjoftim Nr. 05/L - 015, Neni 14 - organi kompetent është i detyruar ta lëshojë letërnjoftimin brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e paraqitjes së kërkesës. Statistikat ditore dëshmojnë se nuk ka tejkalime të këtij afati. "Gjatë muajve të fundit janë paraqitur më shumë kërkesa për aplikim për dokumente personale si letërnjoftim dhe pasaportë, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Agjencia për Regjistrim Civil ka kontratë t vlefshme për furnizim me letërnjoftime dhe furnizimet bëhen sipas kushteve të kontratës", është thënë në njoftimin e Ministrisë së Punëve të Brendshme e cila drejtohet nga Ekrem Mustafa.



# 25 policë të Kosovës trajnohen nga FBI-ja

**Prishtinë, 10 maj (ER)** - "Aktivitete dhe angazhime të rëndësishme ku përfshihen edhe trajnime të niveleve të ndryshme, duke filluar nga ato elementare e deri te trajnimet më të avancuara, kanë qenë dhe mbeten prioritete të planifikimeve të Policisë së Kosovës", kështu është thënë në një komunikatë të Policisë së Kosovës
Në këtë kuadër të këtij bashkëpunimi prioritet ka qenë shtimi i aktiviteteve mbështetëse mjaft të rëndësishme për Policinë e Kosovës nga ICITAP-i amerikan, ku me mbështetjen e tyre nga 6 deri më 10 maj është realizuar "Kursi trajnues - negocimi në situata të krizës" trajnim njëjavor (40 orësh) nga Byroja Federale e Hetimeve (FBI), për 25 anëtarë të Policisë së Kosovës. "Nga këta pjesëmarrës që kanë ndjekur këtë trajnim përfshihen zyrtarë nga njësitë e ndryshme të Policisë së Kosovës, që ka ofruar një mundësi të shkëlqyer për përfitimin e praktikave të reja nga një agjenci me autoritet dhe profesionalizëm të lartë siç është FBI-ja amerikane. Pjesëmarrësit kanë kryer ushtrime klasore dhe në terren të cilat janë realizuar nga ekipi i Byrosë Federale të Hetimeve (FBI) nga ShBA-ja", është theksuar në komunikatën e policisë. Sipas kësaj komunikate, drejtori i përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Rashit Qalaj, ka falënderuar ICITAP-in për kontributin e madh dhe përkrahjen e vazhdueshme që po



jep për mbështetjen e Policisë së Kosovës në fusha të ndryshme, përfshirë edhe trajnimet mjaft të nevojshme dhe profesionale nga ekspertë me renome siç ishin këta të fundit nga FBI-ja amerikane.

# Shënohet 92-vjetori i Shkollës Fillore 'Maxhun Çekaj', vendkomandë e UÇK-së

**Deçan, 10 maj (ER)** - Kryeministri Ramush Haradinaj dhe ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, kanë marrë pjesë të premten në shënimin e 92-vjetorit të Shkollës Fillore dhe të Mesme të Ulët "Maxhun Çekaj" në Irzniq të Deçanit.
Kryeministri Haradinaj ka thënë se është nder për të, që sot mund ta ndajë këtë kohë bashkë, në Irzniq, ku edhe ai ishte nxënës dhe i kaloi të gjitha ato që i kalon një nxënës. "Jam këtu për shkak të njerëzve të këtij fshati, të vlerës së tyre humane e familjare, po ashtu të kundërshtarëve të ideologjive të Jugosllavisë së atëhershme dhe, gjithashtu, ka shtuar se kjo shkollë vërtet mban një emër të respektuar, një emër origjinal, një emër të vendit, një vlerë të këtij vendi, të cilin askush mijëra vjet s'mund ta kontestojë. "Maxhun Çekaj, ishte njeri i jashtëzakonshëm, me vlera të jashtëzakonshme njerëzore, një edukator shembull, i cili është kthyer në prind për luftëtarët e rinj, të cilët i edukoi, i aftësoi dhe nuk i la vetëm", ka thënë kryeministri Haradinaj, duke shtuar se kjo është një vlerë që duhet çdoherë të mbahet me besnikërinë edhe për vlerën kombëtare, patriotike, për vlerën tuaj për liri", ka thënë kryeministri Haradinaj, duke vlerësuar lart rëndësinë e kësaj shkolle. Ai ka thënë se këtu ka shumë porosi që jepen në një vend, procesi i dhënies së dijes, i nxënies, i edukimit të fëmijëve dhe, po ashtu, kjo shkollë ishte edhe vendkomandë e UÇK-së në të cilën janë marrë vendime të rëndësishme për lirinë e vendit.
Haradinaj ka thënë se në këtë shkollë kanë kaluar fëmijë që i kanë takuar gjeneratës së disidentëve, kundërshtarëve të pushtimit, më të madhe, sepse emri i Maxhun Çekajt nderon çdo hero shqiptar dhe të gjithë janë të qetë për arsye se ky emër është i merituar.
Ndërkaq ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë, Shyqiri Bytyçi, ka thënë se ndihet i nderuar që pas kërkesës së DKA-së mori vendim për riemërtimin e kësaj shkolle me ermin e dëshmorit Maxhun Çekaj. Pasi uroi për ditën e shkollës, ai ka thënë se dëshirojnë që shkollat gjithnjë të jenë në festë, për t'i festuar sukseset dhe rezultatet e mira që i arrijnë.
Drejtori i Drejtorisë Komunale për Arsim në Komunën e Deçanit, Bekim Vishaj, në emër të kryetarit të komunës, Bashkim Ramosaj, ka uruar ditën e shkollës, duke theksuar se kjo ditë është e veçantë për shkak se është ditëlindja e profesorit, tani dëshmor, Maxhun Malë Çekaj.
Drejtori i kësaj shkolle, Mehdi Dodaj, ka folur rreth historikut të shkollës që nga themelimi e deri në ditët e sotme, duke thënë se sot janë bashkë për të festuar një datë të rëndësishme, e cila i dha dritë fshatit Irzniq, por edhe fshatrave përreth, datë në të cilën nisën mësimet nxënësit e kësaj ane.
Më tej, drejtori Dodaj ka bërë me dije se sot festojnë edhe njëvjetorin e riemërtimit të shkollës me emrin e dëshmorit të kombit, Maxhun Çekaj.
Kryeministri Haradinaj për kontributin e madh të Maxhun Çekajt për lirinë e vendit e dekoroi atë me medaljen e kryeheroit "Gjergj Kastrioti-Skënderbeu".
Djali i dëshmorit Maxhun Çekaj, Orhani, ka falënderuar kryeministrin Haradinaj për praninë e tij, duke theksuar se dekorimi me këtë medalje flet për kontributin që ka dhënë babai i tij dhe gjithë fshati Irzniq për luftën çlirimtare.
Orhan Çekaj ka falënderuar edhe ministrin e Arsimit, Shyqiri Bytyqi, i cili, siç ka thënë ai, pa hezitim ka nënshkruar vendimin për emërtimin e shkollës "Maxhun Çekaj". Në fund të fjalës së tij, ai ka përshëndetur edhe përfaqësuesit e Lidhjes së Historianëve të Kosovës "Ali Hadri" - Dega në Deçan, kryetarin dr. Shkodran Imeraj, sekretarin Ismet Haskaj dhe anëtarin Tafë Çeku për kontributin e tyre në shumë projekte për promovimin e vlerave të luftës çlirimtare dhe për familjen Çekaj.







## Historiani Ismet Haskaj: Kontributi i Maxhun Çekajt në çështjen kombëtare është shumë i madh

Ismet Haskaj, sekretar i Lidhjes së Historianëve të Kosovës "Ali Hadri" Dega në Deçan, më 2 prill të këtij viti i është drejtuar me një letër kryeministrit Ramush Haradinaj në emër të këshillit të fshatit Jerzniq, që dëshmorit të lirisë, profesorit Maxhun Malë Çekaj, t'i ndahet medalja e kryeheroit "Gjergj Kastrioti-Skënderbeu". Haskaj ka thënë se kontributi i Maxhun Çekajt në çështjen kombëtare është shumë i madh. Sipas tij, dëshmori Çekaj ishte ndër të parët që iu bashkua luftës çlirimtare në rrafshin e Dukagjinit. "Si njeri me kapacitet të lartë intelektual, si mësimdhënës i historisë dhe më pas si profesor i Mbrojtjes, dëshmori i lirisë Maxhun Çekaj ka edukuar gjenerata të shumta në fushën e historisë dhe mbrojtjes së atdheut. Për këtë arsye ai u emërua komandant i shtabit të UÇK-së në fshatin Irzniq", ka thënë Ismet Haskaj.

Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) ka mbajtur takim për kontrollin e armëve të vogla dhe të lehta dhe reduktimin e armëve të paligjshme në Kosovë

# Mbi 800 armë në procedurë të legalizimit

Zëvendësministri i Punëve të Brendshme dhe Koordinatori Kombëtar për Kontrollin e Armëve të Vogla dhe të Lehta (AVL), Izmi Zeka, u ka bërë thirrje qytetarëve ta shfrytëzojnë mundësinë për legalizimin e armëve të kategorizuara B, C dhe D, që në mënyrë të drejtpërdrejtë do të kontribuojnë në ngritjen e sigurisë në bashkësi dhe sigurisë publike në përgjithësi. Ai ka bërë me dije se për gjashtë muaj janë mbi 800 armë në procedurë të legalizimit



EPOKA E RE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 10 MAJ - Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) në bashkëpunim me Programin e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim në Kosovë (UNDP) kanë mbajtur të premten takim për kontrollin e Armëve të Vogla dhe të Lehta (AVL) dhe për reduktimin e armëve të paligjshme në Kosovë.

Zëvendësministri i Punëve të Brendshme dhe Koordinatori Kombëtar për Kontrollin e Armëve të Vogla dhe të Lehta, Izmi Zeka, ka thënë se Republika e Kosovës në fushën e kontrollit dhe menaxhimit të armëve të vogla dhe të lehta ka harmonizuar legjislacionin vendor me praktikat më të mira ndërkombëtare si dhe me direktivën për armë të Bashkimit Evropian. "Kosova është bërë shembull rajonal në këtë fushë dhe synojmë përmbushjen e të gjitha obligimeve që dalin nga rrugëtimi gjithëpërfshirës për Ballkanin Perëndimor në kontrollin e armëve të vogla dhe të lehta deri më 2024", ka thënë Zeka. Ai ka shtuar se MPB-ja që nga dhjetori i vitit të kaluar ka hapur afatin kohor për legalizimin e armëve. Në këtë drejtim, zëvendësministri Zeka ka theksuar se janë shpërndarë edhe broshura për legalizimin e armëve.

Me këtë rast, ai u bëri thirrje qytetarëve të Kosovës që ta shfrytëzojnë mundësinë për legalizimin e armëve të kategorizuara B, C dhe D, që do të kontribuojnë në ngritjen e sigurisë në bashkësi dhe sigurisë publike në përgjithësi. "I ftoj qytetarët për legalizim të armëve. Është një numër i vogël i legalizimit të armëve. Për gjashtë muaj i kemi mbi 800 armë në procedurë. Nëse një armë legalizohet kemi shpëtuar një jetë. Armët pa leje paraqesin rrezik për shoqërinë. Vitin e kaluar 20 raste të vrasjeve që kanë ndodhur kanë qenë armë pa leje. Armët ilegale janë potencial për të eksploduar çdo moment", ka thënë Zeka.

Ndërsa përfaqësuesja e përhershme e UNDP-së në Kosovë, Alessandra Roccasalvo, ka thënë se vlerëson lart MPB-në dhe Policinë e Kosovës për bashkëpunimin e vlefshëm dhe të sinqertë për promovimin e zhvillimit të qëndrueshëm dhe kontributit për një Kosovë më të sigurt. Ajo ka pohuar se angazhimi për ta adresuar kontrollin e armëve të vogla dhe të lehta dhe luftimin e trafikimit të paligjshëm të armëve në Kosovë është pjesë e qëllimit dhe përkushtimit të UNDP-së për ta promovuar sigurinë njerëzore dhe zhvillimin e qëndrueshëm në Kosovë.

Drejtori i Divizionit për Siguri Publike nga Policia e Kosovës, Gazmend Hoxha, ka thënë se PK-ja i ka dhënë përgjigjen e duhur luftimit të trafikimit të armëve të paligjshme në Kosovë. Megjithatë, ai ka pohuar se ende mbetet sfidë mosanëtarësimi i Kosovës në mekanizmat ndërkombëtarë policorë.

Në këtë takim u diskutua edhe lidhur me sigurimin e transferimit të njohurive mbi politikat e OKB-së dhe të BE-së dhe masat aktuale për reduktimin e armëve të paligjshme, mbi gjendjen aktuale dhe masat aktuale në Kosovë për reduktimin e armëve të paligjshme, krimit të bazuar në gjini dhe plaçkitjeve të armatosura etj.

# Loredana Zefi: Paratë nuk u morën me mashtrime, por me vullnet të palës tjetër



PRISHTINË, 10 MAJ (ER) - Rep-artistja Loredana Zefi gjatë ditëve të fundit ishte një ndër artistet që u përfol më së shumti në Kosovë dhe Zvicër. Këngëtarja shqiptare ishte arrestuar dhe më pas liruar nga autoritet zvicerane me dyshimet se e ka mashtruar, zhvatur dhe kërcënuar çiftin zviceran. Këtyre të fundit ishte raportuar se biondina u kishte marrë rreth 900 mijë franga zvicerane.

Por, të premten në një konferencë për media në Prishtinë, Loredana, e cila ishte e shoqëruar edhe nga bashkëshorti i saj, reperi Mozzik, dhe dy avokatët Tom Gashi e Artan Sadiku, ka pranuar se ka marrë para nga çifti zviceran, por ka insistuar se ato para nuk janë marrë as me dhunë e as me mashtrim. "Pika e parë, me rëndësi është se jam në Kosovë, pasi po e xhiroj një videoklip. Kjo është planifikuar shumë më herët. Përmes medieve jam informuar rreth rastit, por gjërat janë ndryshe. Nuk kam ditur asgjë për këtë rast. Prej asnjë personi nuk janë marrë paratë me mashtrime. Paratë janë marrë me vullnet të palës tjetër. Ajo e ka pranuar dhe e ka bërë me dëshirë", ka thënë 24-vjeçarja.

Ajo ka treguar se ky rast ka filluar që nga viti 2016, por nuk ka dhënë detaje se si ka ndodhur rasti dhe si janë marrë paratë. "Kjo gjë ka filluar në vitin 2016, ku unë nuk kam qenë e përfshirë dhe nuk kam ditur asgjë për këtë rast. Më kanë treguar që në vitin 2018 është mundësia për t'u mbyllur ky rast. Unë nuk e di pse nuk është mbyllur. Unë në 2018-n kam qenë në gjendje për të ndihmuar. Nuk më intereson media, as muzika, as asgjë kur është në pyetje familja ime", ka thënë Loredana Zefi. Ajo në këtë konferencë ka thënë se, pavarësisht prej raportimeve të medieve se është arrestuar, kjo nuk është e vërtetë, pasi në polici ka dhënë deklaratë, por nuk është arrestuar. "Rasti do të sqarohet dhe ma merr mendja se këto fjalë kanë për të ndryshuar. Është e vërtetë se kam dhënë deklaratë në polici, por nuk jam burgosur asnjëherë", ka thënë Zefi.

# Iowa e gatshme ta përkrahë zhvillimin e bujqësisë në Kosovë

PRISHTINË, 10 MAJ (ER) - Sekretari i përgjithshëm i Ministrisë së Bujqësisë, Kapllan Halimi, bashkë me kryeshefin ekzekutiv të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë, Ekrem Gjokaj, kanë pritur të premten në një takim një delegacion të shtetit të Iowas, i kryesuar nga drejtoresha ekzekutive e Iowa Sisters States, Heather Jones, të cilët po qëndrojnë në Kosovë për një vizitë zyrtare. Me këtë rast, sekretari Halimi i informoi ata me të arriturat e deritanishme në bujqësi, por edhe me sfidat që vendi ynë ka në këtë sektor. Ai tregoi edhe për progresin e madh që është bërë në vitet e fundit për zhvillimin e bujqësisë përmes mbështetjes së sektorit me grante invesitve dhe subvencione, duke treguar se bujqësia mbetet një prioritet për Qeverinë e Kosovës dhe në vitet e fundit janë bërë investime të mëdha.

Sekretari Halimi ka falënderuar ata për gatishmërinë që shteti i Iowas ka treguar për përkrahjen e bujqësisë në Kosovë dhe shprehi gatishmërinë që bashkëpunimi të thellohet edhe më shumë në të ardhmen.

Nga ana e saj, drejtoresha Heather Jones ka vlerësuar të arriturat e shënuara në sektorin e bujqësisë në Kosovë dhe i ka inkurajuar të vazhdohet edhe më tutje me investime në bujqësi, si një sektor potencial për zhvillim ekonomik dhe hapje të vendeve të reja të punës. Po ashtu, ajo ka shprehur gatishmërinë për ta mbështetur zhvillimin e bujqësisë në Kosovë.



# Lluka: Sektori minerar të hapet për investime të huaja




Tiranë, 10 maj (ER) - Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Lluka, po merr pjesë në konferencën e dytë "Zhvillimi integral i industrisë minerare me ndikim minimal në mjedis", konferencë kjo e organizuar në mes të Kosovës dhe Shqipërisë që po mbahet në Tiranë. Lluka në adresimin e tij para pjesëmarrësve të konferencës ka theksuar rëndësinë e bashkërendimit të aktiviteteve në mes të dy vendeve tona në fushën ekonomike, me fokus në rritjen e konkurrueshmërisë si një treg i përbashkët ekonomik. "Trepça", miniera e magnezitit në Golesh, miniera e re e thëngjillit dhe 11 zonat me interes të veçantë ishin potencialet e përmendura nga ministri Lluka që kanë marrë vëmendje nga Qeveria e Kosovës për të zhvilluar këtë sektor jetik për vendin. "Shtetet në tranzicion që kanë arritur ta zhvillojnë sektorin minerar kanë kaluar fazën e tranzicionit më shpejt, kryesisht për shkak se ky sektor ka kapacitet të thithë investime të huaja më shpejt sesa sektorët e tjerë, që rezulton në punësime të reja, rritje të aktivitetit ekonomik dhe rritje të eksportit, të gjitha këto duke ndikuar në rritje të brutoproduktit vendor. Prandaj, është jetike për mirëqenien e vendeve tona që këtij sektori t'i jepet prioritet në zhvillim", ka thënë ministri Lluka gjatë fjalimit të tij.

Ai ka thënë se bashkëpunimi ekonomik mes dy vendeve tona, së fundi ka rezultuar edhe me investimin e Baltin Group në Ferronikel dhe i cili sot, sipas tij, është një nga eksportuesit më të mëdhenj të vendit tonë, gjithsesi me potencial për zhvillim edhe më të hovshëm. "Ky investim duhet të përdoret si model i bashkëpunimit në mes të dy vendeve tona. Ministria të cilën e drejtoj, përveç të tjerash, ka prioritet krijimin e një ambienti sa më konkurrues në sektorin minerar, si një parakusht për tërheqje të investimeve të huaja dhe zhvillimin e sektorit minerar. Ne tashmë kemi edhe Ligjin për Investime Strategjike i cili eliminon burokracinë dhe krijon bazë të favorshme ligjore për ardhjen e brendeve më të njohura në vendin tonë", është shprehur Lluka.

Konferenca e dytë me temën "Zhvillimi integral i industrisë minerare me ndikim minimal në mjedis" ka mbledhur institucionet e dy vendeve, bizneset dhe ekspertët e fushës dhe do të zgjasë dy ditë. Rekomandimet e kësaj konference kanë për qëllim që t'i ndihmojnë politikëbërësit ta përmirësojnë ambientin e të bërit biznes në sektorin minerar.

## Synohet rritja e bashkëpunimit ekonomik Kosovë - Francë

Prishtinë, 10 maj (ER) - Ambasadori i Francës në Kosovë, Didier Chabert, ka pritur në takim kryetarin e Odës Ekonomike të Kosovës (OEK), Berat Rukiqi, me të cilin ka diskutuar për rrugët dhe iniciativat e mundshme të bashkëpunimit ekonomik Kosovë - Francë.
Ambasadori Chabert ka theksuar nevojën për shtim të angazhimeve institucionale për krijim të sigurisë juridike për investitorët francezë si parakusht për rritje të investimeve nga Franca në Kosovë.
Kryetari i OEK-ut e ka informuar ambasadorin me iniciativat e Odës Ekonomike të Kosovës për nxitje të bashkëpunimit në mes të vendeve të ndryshme, përfshirë edhe Francën, sidomos në sektorët e Turizmit dhe Agrobiznesit.
Rukiqi ka pohuar se Oda Ekonomike e Kosovës është gjithmonë e gatshme t'i ndihmojë bizneset vendore për krijimin e partneriteteve ndërkombëtare në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik dhe avancimit të rolit të sektorit privat si garantues i rritjes ekonomike.



# Lansohet uebfaqja për raportimin e produkteve të rrezikshme




**Me rastin e lansimit të uebfaqes për raportimin e produkteve të rrezikshme "Rapex Kosova", ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Endrit Shala, ka theksuar se ministria që drejton vazhdon të jetë e përkushtuar dhe këmbëngulëse për realizimin e misionit të saj, kontrollin e tregut dhe mbrojtjen e konsumatorit**

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

Prishtinë, 10 maj - Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Endrit Shala, vuri në funksion uebfaqen për raportimin e produkteve të rrezikshme "Rapex Kosova". Shala ka thënë se është i kënaqur për nisjen e këtij projekti, i cili sistem mundëson njoftimin e shpejtë përmes uebfaqes për produktet që paraqesin rrezik serioz për konsumatorët e Republikës së Kosovës. "Për ne prioritet mbi prioritete është mbrojtja e konsumatorit dhe nga sot, me lansimin e kësaj faqeje, konsumatori ynë do të jetë më i mbrojtur, më i sigurt për konsumimin e produkteve që tregtohen në vendin tonë. Ministria e Tregtisë dhe Industrisë vazhdon të jetë e përkushtuar dhe këmbëngulëse për realizimin e misionit të saj, kontrollin e tregut dhe mbrojtjen e konsumatorit", ka thënë ministri Shala. Ai ka bërë me dije se gjatë vitit 2018 MTI-ja ka tërhequr nga tregu produkte të pasigurta në sasi prej 16.213.00 copash.
Prej tyre lodra për fëmijë (në sasi prej 15.077 copësh) dhe pajisje elektrike (në sasi prej 1.135 copash). "Gjithashtu gjatë këtij viti Qeveria e Republikës së Kosovës në pajtim me obligimet ligjore që dalin nga Ligji për Kërkesat Teknike dhe Vlerësim të Konformitetit, ka themeluar Trupin Koordinues për Mbikëqyrjen e Tregut, i cili trup do t'i koordinojë aktivitetet për mbikëqyrjen e tregut me qëllim që produktet e vendosura në tregun e Republikës së Kosovës të jenë të sigurta për konsumatorët", ka thënë Shala.
Ai ka theksuar se kjo faqe e internetit do të ndihmojë për t'u siguruar se publiku është i njoftuar për ekzistencën, përgjegjësit dhe identitetin e secilit autoritet kombëtar për mbikëqyrjen e tregut dhe se si mund të kontaktohet secili autoritet. "Dhe si rrjedhojë e kësaj, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, në bashkëpunim me projektin e financuar nga BE-ja 'Lëvizja e lirë e mallrave', i ka hedhur hapat e saj për krijimin e sistemit 'Rapex Kosova', i cili sistem është në pajtim me praktikat më të mira të mbikëqyrjes së tregut, në këtë mënyrë zbatojmë një pjesë të MSA-së dhe përgatitemi për anëtarësimin e Republikës së Kosovës në BE", ka thënë ai.
Ndërsa kryeinspektori, njëherësh kryetar i Trupit Koordinues për Mbikëqyrjen e Tregut, Lulzim Syla, ka theksuar se qëllimi i uebfaqes është t'u ofrohet siguri konsumatorëve. "Përmes kësaj uebfaqeje synohet t'i ofrohet informacion publikut për autoritetet inspektuese që monitorojnë sigurinë e produkteve në treg dhe veçanërisht për raportimin e produkteve të rrezikshme joushqimore që gjenden në tregun e Kosovës", ka deklaruar Syla.
Shefi për bashkëpunim në Zyrën e Bashkimit Evropian në Kosovë, Luigi Brusa, ka pohuar se mbrojtja e konsumatorëve duhet të jetë detyrë parësore e institucioneve përgjegjëse, duke kërkuar edhe nga konsumatorët që t'i kushtojnë rëndësi asaj që konsumojnë.

## Hyn në fuqi Ligji për ndalimin e lojërave të fatit

Prishtinë, 10 maj - Nga dita e premte ka hyrë në fuqi zyrtarisht Ligji për ndalimin e lojërave të fatit, i cili ndalon funksionimin e bizneseve të lojërave të fatit për 10 vjet. Lajmin e ka konfirmuar për "Radion Evropa e Lirë", Valentina Bytyqi-Sefa, zëdhënëse në Administratën Tatimore të Kosovës (ATK). "Me shfuqizimin e këtij ligji shfuqizohen edhe kompetencat që ka pasur ATK-ja për monitorimin dhe licencimin e subjekteve që kanë ushtruar veprimtarinë e lojërave të fatit. Pas datës 10 maj, për çdo subjekt që nuk i përmbahet ligjit, i cili nuk ndalon aktivitetin e lojërave të fatit, do të merren organet e rendit dhe të drejtësisë", ka thënë Bytyqi.
Ligji që ndalon lojërat e fatit është propozuar nga Qeveria e Kosovës, kurse është miratuar në një seancë të jashtëzakonshme të Kuvendit të Kosovës më 28 mars të këtij viti. Vendimi për mbylljen e lojërave të fatit është marrë, pasi në dy kazino në qytete të ndryshme të Kosovës u patën vrarë dy persona.



## Përkujtohen dëshmorët Afrim Behrami, Ismet Osmani dhe Xhevdet Dobrani



SKENDERAJ, 10 MAJ (ER) - Drejtorët e Komunës së Skenderajt, familjarët dhe përfaqësuesit e shoqatave të dala nga lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, kanë bërë homazhe te varret e dëshmorëve Afrim Behrami, Ismet Osmani dhe Xhevdet Dobrani, në Kompleksin e Dëshmorëve në Izbicë, në kujtim të 20-vjetorit të rënies së tyre dëshmorë. Dëshmorët e kombit janë përkujtuar me respekt të lartë, për sakrificën e tyre në luftën e shenjtë të UÇK-së dhe popullit shqiptar të Kosovës, të cilët dhanë jetën e tyre për lirinë dhe pavarësinë e vendit.



# Fillon seleksionimi dhe paketimi i mbeturinave të riciklueshme në Drenas

DRENAS, 10 MAJ (ER) - Komuna e Drenasit, në bashkëpunim me Kompaninë Rajonale të Mbeturinave (KRM) dhe Green Art Center (GAC), janë duke vazhduar projektin për ndarjen e mbeturinave në burim. Pas rritjes së kapaciteteve për grumbullim të mbeturinave të riciklueshme të amvisërive është shtuar intensiteti i punës së kompanisë për transportim deri në stacionin transferim, vend në të cilin ka filluar edhe seleksionimi i letrës, plastikës dhe kanaqeve, si dhe paketimi i tyre në dengje. Në këtë stacion transferimi është angazhuar një ekip nga një kompani private e Drenasit, "Plastika Mix" sh.p.k., i cili këtë javë ka filluar me seleksionimin dhe paketimin e mbeturinave të riciklueshme. Kjo do të ndikojë në uljen e sasisë së mbeturinave të përziera të cilat përfundojnë në deponi.
Lumnije Krapi, drejtoreshë e Drejtorisë për Shërbimeve Publike dhe Emergjencë, u ka bërë thirrje të vazhdueshme qytetarëve që ta bëjnë ndarjen mbeturinave të riciklueshme si letër, plastikë dhe alumin, më qëllim të rritjes së cilësisë së shërbimeve të grumbullimit të mbeturinave për një mjedis të shëndoshë e të pastër.

## Gjakova, aksion pastrimi në lagjen 'Ali Ibra'

GJAKOVË, 10 MAJ (ER) - Me iniciativë të Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim në kuadër të garës "Për Gjakovë të pastër", ka filluar të premten aksioni për pastrimin e lagjes "Ali Ibra". Ky aksion pastrimi ka përfshirë pjesëmarrjen aktive të shumë banorëve të lagjes, vullnetarëve të OJQ-ve vendore dhe ndërkombëtare. Komuna e Gjakovës është në finalizimin e procedurave ligjore për fillimin e pastrimit të stacionit transferim.



# PDK-ja: Komuna e Fushë-Kosovës manipuloi me pronat e fshatit Miradi e Epërme




FUSHË KOSOVË, 10 MAJ (ER) - Kryetari i Degës së Partisë Demokratike (PDK) në Fushë-Kosovë, Rrahim Tërnava, ka thënë se Komuna e Fushë-Kosovës ka privuar nga e drejta e shfrytëzimit të pronës banorët e Miradisë së Epërme, pasi ka grabitur nga ky fshat 33 hektarë pronë shoqërore, për t'ua ndarë atë banorëve të fshatrave përreth dhe atyre të Batusës së Graçanicës, si kompensim për parcelat që u ishin marrë këtyre vendbanimeve për rregullimin e shtratit të lumit Sitnica.
Në një konferencë për medie, Tërnava ka thënë se dëmi që u është shkaktuar banorëve nga komuna dyshohet se kap shifrën rreth pesë milionë euro. Ai ka kërkuar nga organet kompetente që ta trajtojnë këtë çështje, që prona në fjalë t'u kthehet banorëve që të mund ta shfrytëzojnë për nevojat e tyre dhe të fshatit. "Qytetarët e Miradisë së Epërme që nga viti 2008 kur nisi ky proces në dëm të tyre, nuk kanë reshtur së kërkuari të drejtën e vet për këtë pronë, me numër të ngastrës kadastrale P-72514014-00124-, zonë kadastrale me sipërfaqe 33.829 hektarësh, apo sipërfaqe 338291 m katrorë", ka thënë Tërnava. Ai ka theksuar se çdo kërkesë e banorëve në adresë të komunës dhe institucioneve të drejtësisë nuk është marrë parasysh pavarësisht prej dëmit që kanë pësuar banorët e këtij fshati me privimin nga e drejta për t'i shfrytëzuar këto parcela.
Më tej, Tërnava ka shpjeguar se në vitin 1965 këto toka u ishin marrë prodhuesve individualë të fshatit për ruajtjen e kooperativave bujqësore, ndërkaq me ultimatum të institucioneve të atëhershme dhe me vendim të Qeverisë së Kosovës, kjo parcelë njihet si pronë shoqërore e fshatit Miradi e Epërme.

## Vazhdon hapja e rrugëve fushore në Suharekë

SUHAREKË, 10 MAJ (ER) - Komuna e Suharekës është duke vazhduar projektin "Hapja e rrugëve fushore" në fshatrat e kësaj komune. Kryetari i Suharekës, Bali Muharremaj, ka bërë me dije se sivjet do të hapen 20 kilometra të rrugëve fushore në fshatrat e territorit të komunës që drejton. Muharremaj ka thënë se hapja e këtyre rrugëve do të ndikojë pozitivisht në zhvillimin e bujqësisë në Suharekë. "Projekti 'Hapja e rrugëve fushore' do të vazhdojë këtë vit me 20 kilometra të tjerë, të cilat do të ndikojnë në zhvillimin e bujqësisë. Ne do të vazhdojmë angazhimin në fshatrat si Nepërbisht, Vraniq dhe shumë fshatra të tjerë", ka thënë Muharremaj.



# ‘Liderët’ shqiptarë dhe tri gjërat e ‘mëdha’ të tyre



Nga Jakup KRASNIQI

Gjatë tridhjetë vjetëve të fundit, në Shqipëri dhe Kosovë "liderët" e kombit, që duhej të ishin elita e kombit, kanë qenë të suksesshëm në tri fusha të jetës "politike" dhe historike.
Fillimisht e kushtimisht po them se kanë qenë shumë të suksesshëm:
1. Për të hedhur gur e dru mbi çdo të arritur të shekullit XX në një anë dhe rehabilitimin e tradhtisë në anën tjetër. Asgjëja vlerësohet, vlera e vepra shqelmohet!
2. Për t'i sharë, fyer e degraduar sa më shumë të gjithë kundërshtarët politikë dhe ofruar pranë vetes servilë e puthadorë të çdo natyre.
3. Kanë qenë e janë shumë të suksesshëm që për interesa personale të rrënojnë të tashmen e të ardhmen e kombit e vendit të vet. Çdo gjë publike e kombëtare e trajtojnë si ta kishin krejt personale!
Që të gjithë kryeministrat shqiptarë (në Shqipëri e Kosovë), kur i kanë marrë frerët e sundimit (jo të qeverisjes), gjëja e parë e, mbase, e vetme, ka qenë angazhimi i tyre se si t'ia bëjnë për t'i mashtruar qytetarët në zgjedhjet e ardhshme?! Pastaj, nuk janë kujdesur për zhvillimin e vendit e as për investime aty ku është interesi i kombit, por aty ku fitohet më lehtë, aty ku u krijohet përparësia për zgjedhjet e ardhshme.
Edhe çakordimet, mes krerëve të shteteve shqiptare, si në politikat e brendshme ashtu edhe në ato të jashtme, janë bërë në shërbim të "patriotizmit" zgjedhor, "patriotizmit" për vota. Kjo u vërejt shumë edhe pas takimit të Berlinit.
Prandaj spiralja e përfaqësimit dhe e qeverisjes vazhdon të bjerë. Kush nuk beson, le t'i shikojnë: përfaqësuesit e tyre në Kuvendin e Kosovës, në asambletë komunale dhe në qeverisjen qendrore e lokale! Le të shikojnë se si u përfaqësuan ndër vite.
Këto çakordime politike të brendshme e të jashtme po i dëmtojnë politikat zhvillimore të vendeve tona dhe politikat integruese euro-perëndimore, sidomos në dobësimin e dialogut me Serbinë e cila, edhe pse nuk është distancuar nga krimi e gjenocidi, ka krijuar një përparësi në krahasim me Kosovën.
Ndoshta qeverisjet tona (Shqipëri e Kosovë) ende nuk kanë shkuar në fund të pusit, për të filluar ngritja e përgjegjësisë qeverisëse?!
Shteteve (vendeve) tona u duhet ngritja, por si dhe kush duhet ta bëjë?! Kjo është çështja! A mund të bëhet ngritja pa dije e dashuri ndaj kombit e vendit?
Apo përfaqësuesit tanë ne institucione ende nuk jemi të pjekur për sistemin e vlerave demokratike?!

# Shkarkohet një prokuror dhe suspendohet një prokurore

PRISHTINË, 10 MAJ (ER) - Këshilli Prokurorial i Kosovës ka mbajtur mbledhjen e radhës, të udhëhequr nga kryesuesi Bahri Hyseni, në të cilën janë shqyrtuar dhe marrë vendime për pikat e parapara të rendit të ditës. Një ndër çështjet më të rëndësishme ishte miratimi i themelimit të dy mekanizmave, të cilët janë përcaktuar në Strategjinë për Krimet e Luftës, Taskforcës për përpunimin e analizës së resurseve, të cilin do ta përbëjnë përfaqësues nga Këshilli, Prokurori i Shtetit dhe Policia e Kosovës, si dhe Trupit Monitorues për monitorimin dhe vlerësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të zbatimit të kësaj strategjie, të cilin do ta përbëjnë kryesuesi i Këshillit, kryeprokurori i Shtetit, një përfaqësues i Policisë së Kosovës, Ministrisë së Drejtësisë dhe Zyrës së BE-së në Kosovë.
Po ashtu, Këshilli ka marrë vendim për t'i propozuar presidentit të vendit shkarkimin nga detyra të prokurorit Agron Matjani për shkak të mosrespektimit të rëndë të detyrave zyrtare, vendim ky i cili ka ardhur pas zhvillimit të procedurave disiplinore nga komisioni përkatës.
Në vijim, Këshilli miratoi kërkesën e Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit për suspendim nga detyra me pagesë të një prokuroreje, ngaqë dyshohet për shkelje të detyrës zyrtare, si dhe ka obliguar Komisionin përkatës që t'i trajtojë këto shkelje.
Në këtë kontekst, kryesuesi i Këshillit, Bahri Hyseni, ka thënë se secili vendim i këtij institucioni ka peshë të madhe. Andaj, Këshilli dhe Prokurori i Shtetit janë bartës të ngritjes dhe fuqizimit të transparencës, efikasitetit, llogaridhënies, integritetit dhe dinjitetit të sistemit prokurorial të Kosovës.
Gjithashtu, anëtarët e Këshillit miratuan edhe kërkesën e kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Gjakovë, për të cilën u mor vendim që të bëhet shpallja e brendshme për avancim të një prokurori nga Departamenti i Përgjithshëm në Departamentin për të Mitur, pas shkuarjes në pension të prokurorit Xhavit Osmani.





# Hiqen panotë reklamuese pa leje në Mitrovicë

MITROVICË, 10 MAJ (ER) - Me kërkesë të Drejtorisë për Planifikim dhe Urbanizëm, të premten inspektorët komunalë kanë ndërmarrë aksionin për heqjen e panove reklamuese, tabelave për njoftime afariste, si dhe dekoreve e reklamacioneve të ndryshme të vendosura në shtylla e hapësira të tjera publike, pa lejen adekuate nga autoritetet komunale.
Deri më tani janë hequr materiale në afërsi të urës së Ibrit, bankës "TEB", te xhamia "Isa Beg", në afërsi të kompanisë "Ipko", mbi "Urën e Gjakut" si dhe në disa segmente të tjera.
"Ky aksion do të vazhdojë edhe në lokacione të tjera brenda territorit të Komunës së Mitrovicës. Këto veprime janë ndërmarrë me qëllim të lirimit të hapësirave publike, gjegjësisht heqjen e tezgave, reklamacioneve të ndryshme si dhe materialeve të tjera të vendosura pa leje adekuate të cilat pengojnë qarkullimin e lirë të qytetarëve", është thënë në njoftimin e Komunës së Mitrovicës.
Kompania "Lirigzoni" është e kontraktuar nga komuna për heqjen e panove reklamuese, ndërsa monitorimin e zbatimit të këtij vendimi po e bëjnë inspektorati komunal dhe Drejtoria e Urbanizmit.
Komuna e Mitrovicës u ka bërë thirrje të gjitha subjekteve afariste dhe qytetarëve të interesuar që të aplikojnë për lejen përkatëse për vendosjen e materialeve të tilla, në bazë të kushteve të planifikimit urban, gjithmonë në interes të qarkullimit të lirë të qytetarëve.

## Pompeo do të takohet me Putinin në Rusi



UASHINGTON, 10 MAJ - Departamenti amerikan i Shtetit ka njoftuar se sekretari amerikan i Shtetit, Mike Pompeo, do të takohet me presidentin rus, Vladimir Putin dhe ministrin e Jashtëm rus, Sergei Lavrov, gjatë një vizite në Rusi më 13 dhe 14 maj. Përmes një deklarate të publikuar më 10 maj, zëdhënësi i Departamentit të Shtetit, Morgan Ortagus, ka thënë se bisedimet e Pompeos me Putinin dhe ministrin Lavrov do të zhvillohen në Soçi të Rusisë më 14 maj.
Ortagus, po ashtu, ka thënë se aty do të diskutohen sfidat me të cilat përballen Rusia dhe Shtetet e Bashkuara. Pompeo pritet që të takohet edhe me pjesëtarë të Ambasadës Amerikane në Moskë si dhe me liderë afaristë amerikanë në Rusi.
Aktualisht Shtetet e Bashkuara dhe Rusia kanë mospajtime rreth rolit që ka secili shtet në Venezuelë, pasi përkrahin palë të kundërta.

# Hetimet mbi Rusinë mbeten temë e nxehtë politike

Derisa disa republikanë thonë se është koha për ta lënë pas procesin hetimor lidhur me ndërhyrjet ruse, në anën tjetër nuk duket se presidenti Trump, apo kritikët e tij demokratë, janë të gatshëm për një kapitull të ri



UASHINGTON, 10 MAJ - Përkrahja për presidentin Donald Trump është rritur, duke arritur në 46 %, sipas një ankete të organizatës Gallup. Ky është niveli më i lartë i përkrahjes që nga ditët e para të presidencës së Trumpit. Disa republikanë thonë se është koha për ta lënë pas procesin hetimor lidhur me ndërhyrjet ruse. Por nuk duket se presidenti Trump, apo kritikët e tij demokratë, janë të gatshëm për një kapitull të ri.
Gjatë tubimit për fushatë në Florida, presidenti u kujtoi përkrahësve përfundimet e raportit të Prokurorit të Posaçëm, Robert Mueller. "E patë çfarë ndodhi? Nuk u zbulua bashkëpunim i fshehtë. Nuk u zbulua pengim i drejtësisë. Asgjë. Duan të vazhdojnë me këtë marrëzi. Ndoshta po e analizoj gabim, por kështu si po shkon po na çojnë drejt fitores në 2020-ën, pasi njerëzit e kuptojnë çfarë po ndodh", tha Trumpi.
Hetimet nuk zbuluan bashkëpunim të fshehtë mes fushatës së presidentit dhe Rusisë për të ndërhyrë në zgjedhjet e 2016-ës.
Prokurori Mueller nuk doli me konkluzion lidhur me dyshimet për pengim të drejtësisë, por as nuk u shpreh se presidenti ishte provuar i pafajshëm. Presidenti ka deklaruar disa herë se raporti e nxori të pafajshëm.
Republikanët thonë se ka ardhur koha për ta lënë pas procesin hetimor. "Përfundoi. E kuptoj përse miqtë tanë të kahut tjetër politik janë të zhgënjyer. Janë përpjekur kaq shumë për të gjetur një mënyrë që të anulonin rezultatin e zgjedhjeve të 2016-ës", tha kreu i republikanëve në Senat, Mitch McConnell.
Demokratët po përpiqen ta ndëshkojnë Prokurorin e Përgjithshëm William Barr për mosbindje ndaj Kongresit, sepse nuk pranoi të dorëzonte raportin e prokurorit Mueller në formë të plotë. "Ata po bllokojnë të drejtën e amerikanëve për informacion. Është e papranueshme", thotë ligjvënësi demokrat Jerry Nadler.
Megjithatë, mes demokratëve ka dy kampe, pro dhe kundër fillimit të procesit për shkarkimin e presidentit. "Procesi për shkarkim është një ndër më përçarësit që mund të ndërmarrim. Nëse e marrim atë rrugë, duhet t'i kemi të garantuara shanset e suksesit", tha kryetarja e Dhomës së Përfaqësuesve, Nancy Pelosi.
Republikanët kontrollojnë Senatin, duke i bërë shumë të vështira shanset e suksesit në procesin për shkarkim që mund të hapin demokratët, thotë eksperti David Abraham. "Një proces për shkarkim që nuk ka aspak mbështetje nga republikanët do të përshkruhet gjatë fushatës zgjedhore si vazhdim i gjuetisë së shtrigave nga demokratë që nuk duan ta pranojnë se humbën zgjedhjet", tha ai.
Hetimet mbi ndërhyrjet ruse mbeten një temë e hapur politike dhe do të jenë pjesë e debatit presidencial, thotë eksperti John Fortier. "Demokratët janë shumë të pakënaqur me presidentin, ndërsa shumë prej republikanë janë shumë të kënaqur me të. Kjo formulë krijon mobilizim politik. Megjithëse krijon situatë të acaruar, ajo i nxit njerëzit të dalin e të votojnë në zgjedhje", tha Fortier.
Me gjithë zhurmën që shkaktoi procesi hetimor, populllariteti i presidentit Trump ka mbetur pak a shumë i pandryshuar, thotë analisti Matt Dallek. "Niveli maksimal që ka arritur është mjaft i ulët- rreth 44%. Nuk ka kapur kurrë 50% mbështetje. Është hera e parë që kur filluan anketat që një president nuk kap nivelin 50% të mbështetjes. Por edhe niveli minimal është mjaft i qëndrueshëm. Ai nuk ka rënë asnjëherë nën 36 %", tha Dallek.
Presidenti vazhdon të deklarojë se raporti e nxori të pafajshëm, ndërsa demokratët do t'ia vazhdojnë seancat dëgjimore mbi veprimet e administratës. Por fjala e fundit u takon votuesve në zgjedhjet presidenciale të nëntorit 2020.

# Kina ngre akuza ndaj ish-presidentit të Interpol-it



Pekin, 10 maj - Prokurorët kinezë ngritën zyrtarisht akuza për shpërdorim detyre dhe ryshfet kundër ish-presidentit të Interpolit Meng Hongwei.
Njoftimi u bë të premten nga zyra e prokurorit në qytetin verilindor të Tianjin. Në njoftim thuhej se Meng ka abuzuar me pushtetin gjatë kohës që mbante detyrën e zëvendësministrit për sigurinë publike, si dhe kreut të rojës bregdetare të Kinës dhe se kishte marrë në formë ryshfeti "një shumë të madhe" parash. Bashkëshortja e Meng, Grace, e cila jeton në Francë, i ka hedhur poshtë akuzat dhe thotë se arrestimi i tij është bërë për qëllime politike.
Meng Hongwei ishte përjashtuar nga detyrat publike dhe Partia Komuniste kineze, përpara se të arrestohej zyrtarisht muajin e kaluar. Ai u zgjodh president i Interpolit në 2016-n. Në shtator të vitit të kaluar ai rezultoi i zhdukur gjatë një vizite në vendin e tij të origjinës.

## Koreja e Veriut hedh dy raketa me rreze të shkurtër



PHENIAN, 10 MAJ - Ushtria e Koresë së Jugut thotë se Koreja e Veriut duket se ka lëshuar dy raketa me rreze të shkurtër. Kjo është hera e dytë brenda një jave që Pheniani ka hedhur raketa. Provat me raketa rrezikojnë edhe më tej bisedimet bërthamore mes udhëheqësit koreanoverior Kim Jong Un dhe presidentit Trump.
Shtabi i Ushtrisë së Koresë së Jugut informoi se raketat u lëshuan nga provinca e Pjonganit Verior, në veriperëndim të vendit dhe fluturuan drejt lindjes.
Presidenti i Koresë së Jugut Moon Jae-in po i bën thirrje Koresë së Veriut të ndalë hedhjen e raketave, të cilat ai thotë se vështirësojnë përpjekjet diplomatike për çnuklearizimin e gadishullit korean. "Nuk e konsiderojmë shkelje të marrëveshjes ndër-koreane. Megjithatë, do të doja ta paralajmëroja Korenë e Veriut se nëse përsërit veprime të tilla, mund t'i vështirësojë bisedimet dhe negociatat që janë duke u zhvilluar", tha Presidenti i Koresë së Jugut, Moon Jae-in.
Nga Shtëpia e Bardhë, presidenti Donald Trump tha se askush nuk është i kënaqur me lëshimin e raketave nga Koreja e Veriut.







# **BeyAb** for bread

Risi, tani BEYAB-in mund ta gjeni edhe nëpër dyqanet e Kosovës. BeyAb është prodhim turk, dhe përpos tregut në Shqipëri e Mal të Zi tani edhe në Kosovë.






E rrallë

## Zhytësi mbijetoi 38 minuta pa oksigjen



Në një natë të stuhishme në Detin e Veriut në shtator të vitit 2012, Chris Lemons u përball me vdekjen. Ai mbeti i bllokuar në një platformë nënujore të pozicionuar mbi një pus nafte të ngrirë. Ai kishte vetëm pak minuta oksigjen në rezervuarët e emergjencës, të ngjitur në kostumin e zhytjes. Chris Lemons tregon makthin e tij, e të jetuarit pa oksigjen për 38 minuta, ndërkohë që njerëzit normalë qëndrojnë vetëm tre minuta pa marrë frymë.

FOTO E DITES



Artisti italian Lorenzo Quinn ka bërë një skulpturë që tregon gjashtë palë duar që bashkohen. /AFP/

E jashtëzakonshme

## Hoteli në formën e patates, brendësia e tij është magjepsës

Në Amerikë në Idaho është ndërtuar një hotel në formë të patates. Patatja hotel prej 6 tonësh, e cili quhet 'Big Idaho Potato Hotel', është në dispozicion për t'u rezervuar. Nga brenda ky hotel duket shumë i bukur.



## BARSOLETA E DITËS



- Kjo është e tmerrshme, bërtiti mësuesja.
- Ti Astrit fle gjithë orën e mësimit. Si do të mësosh ti?!
- Në ëndërr po shikoja një orë mësimi, mësuese!

KINO ABC PRISHTINE

## Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

**Në ora 16:00**

### "HOW TO TRAIN YOUR DRAGON; The Hidden World" 3D

I Animuar/Aksion Aventure; 1 ore 44 min

Rolet: Jay Baruchel, America Ferrera, Cate Blanchett, Kit Harrington, Craig Ferguson, F. Murray Abraham, etj.
Regjia: Dean DeBlois





**Në ora 18:00 (gjate vikendit ne ora 14:00 dhe 18:00)**

### "THE KID WHO WOULD BE KING",

Aventurë/Familjar/Fantazi; 1 ore 50 min

Rolet: Louis Ashbourne Serkis, Dean Chaumoo, Tom Taylor, Rhianna Dorris, Angus Imrie, Rebecca Ferguson, Patrick Stewart, etj.

Regjia: Joe Cornish

**Në ora 20:00**

### "CAPTAIN MARVEL" 3D

Aksion/Aventurë/Sci-Fi; 2 ore 08 min

**Rolet:** Brie Larson, Samuel L. Jackson, Ben Mendelsohn, Djimon Hounsou, Lee Pace, Gemma Chan, Annette Bening, Jude Law, etj.

**Regjia:** Anna Boden, Ryan Fleck





**Në ora 22:00**

### "U S"

Horror/Triller; 1 ore 56 min

**Rolet:** Lupita Nyong'o, Winston Duke, Elisabeth Moss, Tim Heidecker, Yahya Abdul-Mateen II, Anna Diop, Evan Alex, Shahadi Wright Joseph, Madison Curry, Cali Sheldon, Noelle Sheldon
**Regjia:** Academy Award®-winning visionary Jordan Peele

**Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**



**DASHI**
Sot jeni aq komod sa nuk keni aspak dëshirë të reagoni apo të vendosni. Do ta lini gjithçka në dorë të të tjerëve dhe po ju pëlqen kjo ndjesi.



**DEMI**
Keni pranë vetes një mik të vërtetë që ju këshillon dhe ju rri pranë kur ju jeni në vështirësi. Sot është dita për t'i qenë mirënjohës.



**BINJAKËT**
Çdo gjë që ka të bëjë me shëndetin tuaj ose të familjarëve sot ju ka mërzitur disi. Kontrollet e shpeshta do të jenë ato që do t'ju qetësojnë.



**GAFORRJA**
Gjërat e vogla janë ato që do të bëjnë lumturinë tuaj sot. Partneri është bashkudhëtari juaj në ëndrrën për të ardhme së bashku.



**LUANI**
Ato që thuhen në momentin e gabuar mund të prekin njerëz që për ju janë vërtet të rëndësishëm. Sot do të pendoheni për një fjalë të thënë.



**VIRGJERESHA**
Do t'ju duhet të jeni mjaft të programuar sot. Punët dhe agjenda e ngarkuar që keni nuk do t'ju lënë asnjë moment të lirë për t'u çlodhur.



**PESHORJA**
Një ditë e zhurmshme kjo e sotmja e karakterizuar nga humori dhe të qeshura pa fund. Familja është streha juaj e ngrohtë në çdo moment.



**AKREPI**
Arti dhe muzika janë ato qe do t'ju shoqërojnë përgjatë gjithë ditës. Sot do të ecni me zemër dhe jo me arsye.



**SHIGJETARI**
Sot po shpresoni të mos keni vizita të paprogramuara, por do të ndodhë krejt e kundërta. Do t'ju ngatërrohen situatat dhe personat.



**BRICJAPI**
Biznesi dhe marrëveshjet janë pika juaj e fortë sot. Do t'ju kërkojnë ndihmë dhe do të dini të jepni atë që do t'ju kërkohet pa shumë problem.



**UJORI**
Entuziazmi juaj që fillon që në orët e para të mëngjesit do të lerë pa fjalë bashkëpunëtorët tuaj. Vitaliteti që ju shoqëron sot do t'ju mbajë për ca ditë.



**PESHQIT**
Edhe pse dita e sotme është mëse e zakonshme, për ju do të shndërrohet në një ditë feste. Lajmi që do të merrni do t'ju gëzojë pa masë.

# Ed Sheeran dyfishon pasurinë, lë pas Adelen




Këngëtari i mirënjohur Ed Sheeran ka dyfishuar pasurinë. Në vitin e fundit pasuria e tij ka shkuar deri në 160 milionë paund. Ai mban vendin e 17 si muzikanti më i pasur në Britani duke lënë pas Adelen në vendin e 22-të me 150 milionë paund pasuri.



# Fejohet Hilary Duff

Hilary Duff është fejuar. Aktorja 31-vjeçare ka dhënë lajmin në llogarinë e saj në "Instagram", duke njoftuar se Matthew Koma i ka propozuar asaj. "Ai më pyeti të isha gruaja e tij", ka shkruar Hilary. Aktorja dhe i fejuari i saj janë në lidhje që nga viti 2017 dhe kanë një vajzë së bashku. Hilary ka edhe një djalë nga martesa e saj e mëparshme.

# Shtëpia e Rita Orës në Prishtinë kushton 1.7 milion euro



Së fundmi u bë me dije se këngëtarja shqiptare me famë botërore, Rita Ora, ka blerë një shtëpi për prindërit e saj në Prishtinë. Sipas "The Sun", rezidenca e saj ka kushtuar rreth 1.7 milion euro. Nga një listë e pasurisë që është publikuar pak kohë më parë, Rita tashmë ka 18 milionë funte pasuri. Ka qenë vetë nëna e Ritës, Vera, e cila e në profilin e vet në "Instagram" ka publikuar shtëpinë e tyre luksoze, duke qenë shumë krenare për të.

# Së shpejti dokumentari nga vëllezërit Jonas




Vëllezërit Jonas po realizojnë një dokumentar. Ata zbuluan lajmin përmes një videoje të cilën e publikuan në rrjetet sociale. Dokumentari do të dalë më 4 qershor. Ai flet për famën e tyre, lidhjen si vëllezër, si dhe ka intervista thellësisht personale, pamje të pabotuara që nuk i keni parë kurrë më parë.







# Kanariet, shtatë ishuj dhe plazhe për të gjitha shijet

## Mijëra mundësi nga Fuerteventura te La Palma, në një përzierje të mrekullueshme të Afrikës dhe Europës



Tenerife, Fuerteventura, Gran Canaria, Lanzarote, La Palma, La Gomera, El Hierro janë shtatë ishujt kryesore të arkitekturës madhështore të Kanarisë, një nga destinacionet më të famshme turistike në botë.

Në Spanjë, Kanaritë janë ishuj tropikalë, shumë të ndryshëm nga njëri-tjetri, një natyrë vullkanike, e cila rritet në Atlantik përballë Marokut. Kryeqyteti është i dyfishtë: Santa Cruz e Tenerife dhe Las Palmas në Gran Canaria.

**Tenerife, më i madhi –** Me një sipërfaqe prej mbi dy mijë kilometra katrorë dhe një popullsi prej mbi 900 mijë banorë, Tenerife është ishulli më i madh në arkipelag dhe më i populluari në Spanjë. Kryeqyteti i saj është qyteti dinamik Santa Cruz dhe i famshëm për natën e saj. Zbuloni kuzhinën e Tenerife që tërheq mirësinë e saj nga freskia e pashtershme e peshkut, e cila ofrohet në restorante të mira, por edhe në fshatrat piktoreske të peshkatarëve të bregdetit. Mishi është gjithashtu shumë i shijshëm, zakonisht i gatuar në tavë dhe i zbukuruar me esencat aromatike të ishullit.



**Plazhet madhështore –** Le të sjellim në vëmendje disa nga plazhet e bukura të Tenerife: Las Teresitas është vetëm disa minuta nga Santa Cruz dhe është i famshëm për shumë restorante peshku që rrethojnë ujin e pastër dhe plazhin shumë fin; Jo shumë larg është plazhi Fañabé, vendi i përsosur për sportet e ujit. Pastaj është spektakolari Playa de Los Gigantes që ofron një mjedis natyror që me të vërtetë të lë pa frymë, i rrethuar nga shkëmbinjtë imponues që arrijnë lartësinë 800 metra dhe Playa Tejita, i cili fsheh në këmbët e tij një gji të vogël të frekuentuar nga naturistët. Playa Jardin në Puerto de la Cruz është një mrekulli e formuar nga njeriu dhe është nderuar me çmimin Flamurin Blu.

**Ishulli i sportistëve –** Fuerteventura, rezerva e biosferës së UNESCO-s, është ishulli më i afërt i Kanarisë në brigjet afrikane, që është më pak se 100 kilometra larg. Është i sheshtë, i mbushur me plazhe të bukura dhe që fryn shumë erë si Corralejo, Playa del Bajo Negro, Isla de Lobos e egër, të cilat janë një parajsë e vërtetë për surfers dhe adhuruesit e zhytjes.

**Gran Canaria –** Ndër plazhet më të njohura dhe më popullore të Gran Canaria, ishulli i tretë më i madh në ishujt Kanarie është Las Palmas, shumë i organizuar. Në frontin e ujërave me një ngjyrë të pabesueshme ngjyrë bruze, këtu është Playa des Ingles, i cili është në kërkim të argëtimit. Klubet e natës dhe diskotekat janë të shumta. Gjithashtu plazhi i Puerto Rikos nuk zhgënjen dhe rekomandohet sidomos për familjet me fëmijë.



**Lanzarote madhështore –** Megjithëse peizazhi i saj u trondit nga një shpërthim i tmerrshëm në vitet 700, shumë e konsiderojnë Lanzarote ishullin më të bukur të Archipelago dhe plazhet e tij nuk e kundërshtojnë këtë mendim, si Playa Francesa nga deti tepër transparent ose Playa de Papagayo me ujërat e një bruz jurosor të përshtatur nga një peizazh hënor. Ia vlen të shijosh edhe verën e shkëlqyer që prodhohet këtu.

La Palma dhe La Gomera – La Palma është ishulli më perëndimor i Kanarieve dhe një nga ato më pak turistike. Plazhet janë me rërë të errët si Puerto de Tazacorte, shumë mirë të pajisur dhe të qetë dhe prandaj janë të përshtatshëm edhe për fëmijët. Plazhi i Las Palmasit është i famshëm mes adhuruesve të zhytjes për shtratin e detit. Ishulli i La Gomera ka plazhe të mrekullueshme sidomos në bregdetin jugor. Mos humbisni Playa Alojera, rrethuar nga shkëmbinjtë e tmerrshme ose Playa de Vallehermoso, dyqind metra rërë dhe guralecë ose plazhi i Santa Catalina, i dashur nga surfers.

**Më i vogli –** El Hierro është më i vogli dhe më i egri i ishujve Kanarie: një oaz i vërtetë natyror larg turizmit masiv. Ai krenohet me shtratin e detit të jashtëzakonshëm për ata që duan zhytjen dhe plazhet e mrekullueshme, veçanërisht në bregun jugor, ku ju mund të zhyteni në pishina të pabesueshme natyrore si Charco Manso dhe La Maceta. La Restinga, La Caleta, surreali Playa de Verodal janë gjithashtu shumë të njohura. *Gazeta Shqip*







# Kujdes nga peshku-vrasës, noton në ujërat e Mesdheut

Për herë të parë është parë peshku-akrep në ujërat italiane, më saktësisht në rezervat natyrore të oazit të faunës në Vendicari, në Sicili dhe menjëherë ka rënë alarmi. Peshku-akrep, ose "lion-fish", është një peshk tropikal, me tipare të panjohura dhe gjendet natyrisht në Detin e Kuq, në Oqeanin Indian dhe në Paqësor.
Bëhet fjalë për një nga peshqit më invaziv në botë: në vitet '90, ai u shfaq në Florida dhe në pak vite u përhap në të gjitha ujërat e Karaibeve me një impakt ekologjik të rëndësishëm.
Peshku-akrep është një gjitar i shkëlqyer dhe për këtë motiv ndikon negativisht në biodiversitetin ujor të brigjeve. "Lionfish" është i dëmshëm edhe për njeriun: përmes gjembave të tij, injekton helm që mbetet aktiv edhe për 24-48 orë. Pickimi i tij "krijon një dhimbje të fortë dhe të vazhdueshme, shpesh të shoqëruar me simptoma të tilla si të përziera, vjellje, temperaturë, konvulsione, vështirësi në frumëmarrje dhe diarre".
Në rastet më të rënda, pjesa e goditur, mund të përjetojë një nekrozë lokale dhe një humbje të ndjeshmërisë që mund të zgjasë për shumë ditë.
Në rast të pickimit, gjëja e parë që duhet të bëni, është të hiqni gjembat, të dezinfektoni plagën dhe të vendosni sa më shpejt ujë të ngrohtë në zonën e prekur. Ngrohja prish strukturën e proteinave dhe toksina ndihmon në reduktimin e dhimbjeve.











# 72-vjeçari kalon Atlantikun me një fuçi!

E pabesueshme, por e vërtetë, një burrë ka thyer çdo parashikim, teksa ka kaluar i vetëm Oqeanin Atlantik mbi një fuçi të madhe.
Jean-Jacques Savin, një parashutist dhe pilot 72-vjeçar që sapo përfundoi udhëtimin nga Ishujt Kanarie në një ishull në Karaibe. Ai kaloi disa muaj duke përsosur 'anijen' e tij për të kaluar përmes Atlantikut.
Savin u nis nga Ishujt Kanarie, jashtë brigjeve të Afrikës, më 26 dhjetor 2018 dukë udhëtuar në perëndim me fuçinë e ndërtuar vetë.
Savin kaloi katër muajt e parë të vitit 2019 në fuçinë e tij, duke udhëtuar rreth dy kilometra në orë pa motor, dhe duke u mbështetur tërësisht në rrymat dhe erërat në oqeanin.
Ai habiti vendasit kur mbërriti në ishullin e vogël holandez të Karaibeve, Saint Eustatius pak pas mesnatës së javës së shkuar.
Pas mbërritjes në destinacion gjendja e tij shëndetësore ishte e mirë. 71-vjeçari udhëtoi vetëm në anijen e tij të punuar me dorë, e cila ishte rreth 10 metra e gjatë dhe 7 metra e gjerë dhe përfshinte një kuzhinë dhe shtrat të vogël dhe hapësirë për ruajtje. Ai ushqeu veten me peshqit e kapur nga oqeani.












Sport

QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"

TEL: 045 82 82 82

# Fitorja, opsion i vetëm për Prishtinën dhe Llapin

Derbi i xhiros së 31-të në Superligë në mes të Prishtinës dhe Llapit do të zhvillohet sot (e shtunë) në stadiumin "Fadil Vokrri". Të dyja skuadrat kanë paralajmëruar se do të luajnë për fitore, kurse dështimi për secilën skuadër mund të jetë dalje jashtë garës për titull të kampiones në elitë

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 10 MAJ - Fitorja është opsion i vetëm për Prishtinën dhe Llapin në derbin e javës së 31-të në IPKO Superligën e Kosovës në futboll. Çdo rezultat tjetër mund të qesë njërën apo tjetrën skuadër nga gara për titull të kampionit.
Kapiteni i Prishtinës, Armend Dallku, pret që skuadra kryeqytetase të shënojë fitore ndaj Llapit në stadiumin "Fadil Vokrri". "Mund ta quajmë si duel parafinale, por ne kemi mbajtur ekipin maksimalisht të përqendruar për këtë ndeshje, pastaj edhe për dy ndeshjet e tjera, por na gëzon fakti që luajmë në stadiumin tonë. Mos të harrojmë se në çfarë mënyre është sjell ekipi kundërshtar në ndeshjen e fundit në Podujevë dhe kjo duhet të na motivojë neve si futbollistë që brenda fushës të kemi motiv shtesë që t'i kundërvihemi në mënyrën e duhur edhe për atë ndeshje. Shpresojmë të jemi në maksimumin e kondicionit të gjithë futbollistët deri në ditën e ndeshjes, ta japim maksimumin dhe t'i gëzojmë shikuesit tanë që do të jenë të pranishëm", ka thënë Dallku.
Fitore ka paralajmëruar edhe trajneri i Llapit, Tahir Batatina. "Në çdo ndeshje futemi për fitore dhe me këtë qëllim udhëtojmë edhe ndaj Prishtinës. Llapit nuk i interesojnë shumë rezultatet e tjera pasi ne duam t'i marrim tri fitore në tri ndeshjet e fundit dhe të shpallemi kampionë", ka thënë Batatina, i cili konfirmoi se nuk ka mungesa dhe se në ndeshjen ndaj Prishtinës do të luajë me formacionin më të fortë. Prishtina në këtë ndeshje do të jetë pa Meriton Korenicën, kurse Ahmet Haliti rikthehet në formacion.



## Feronikeli kërkon tri pikë, Drita rezultat pozitiv

Sulmuesi Kastriot Rexha ka thënë për gazetë se skuadra e Feronikelit synim të vetëm e ka fitoren në ndeshjen ndaj Dritës. "Ndeshja me Dritën do të jetë e rëndësishme për ne, pasi jemi në garë të ngushtë me Prishtinën dhe Llapin për titull. Dihet se Drita nuk ka presion dhe ka skuadër të mirë, çka dëshmoi edhe në ndeshjen e kaluar kur e ndali Prishtinën, duke e nderuar kampionatin dhe e njëjta mund t'i ndodhë edhe Feronikelit, por kjo është në të mirë të futbollit të Kosovës. Ne jemi të përgatitur maksimalisht dhe objektivi i vetëm në këtë ndeshje është fitorja. Duhet të vazhdojmë me lojëra të mira edhe në këto ndeshjet e mbetura dhe ta arrijmë qëllimin e klubit", ka thënë Rexha.
Për ndeshjen që zhvillohet sot (e shtunë) në Drenas foli edhe Përparim Livoreka, i cili në të kaluarën ka qenë pjesë e skuadrës së Feronikelit. Ai ka bërë me dije se synim i Dritës në këtë ndeshje është rezultati pozitiv. "Do të jetë një ndeshje shumë interesante dhe e fortë, pasi dihet se Feronikeli ka skuadër cilësore dhe në këtë ndeshje është vendës. Ne do të përgatitemi në maksimum. Synim e kemi të marrim rezultat pozitiv edhe në këtë ndeshje. Ende nuk e dimë për mungesa por, pavarësisht se kush luan, që të gjithë do ta japim maksimumin për hir të kampionatit", ka thënë Livoreka.

## Ferizaj 'fluron' në tabelë, fiton edhe Ballkani

Të premten janë zhvilluar tri ndeshjet e elitës për javën e 31-të. Rezultatet kanë qenë mjaft interesante, ku spikat fitorja e Ferizajt ndaj Trepçës '89 në Mitrovicë (1-2). Golat për skuadrën e Bylbyl Sokolit i shënuan Dardan Çerkini (55) dhe Ermal Krasniqi (71), kurse për vendësit golin e vetëm e shënoi Arb Manaj (81). Pas kësaj fitore Ferizaj është ngritur në pozitën e pestë me 40 pikë, kurse '89-shi bie në pozitën e tetë me 39 pikë. Fitore si vendës ka shënuar skuadra e Ballkanit, e cila e mposhti Gjilanin (1-0). Golin e vetëm në ndeshjen e zhvilluar në Suharekë e shënoi Blend Baftiu në minutën e 56. Pas kësaj fitore Ballkani është larguar përkohësisht nga zona e barazhit, kurse Gjilani duket se barazhin e ka të pashmangshëm. Ndeshja e tretë e zhvilluar në Prishtinë në mes të Flamurtarit dhe Drenicës përfundoi me rezultat 0-0.

### IPKO SUPERLIGA

| | |
|---|---|
| Flamurtari - Drenica | 0-0 |
| Ballkani - Gjilani | 1-0 |
| Trepça '89 - Ferizaj | 1-2 |

Të shtunën takohen:
Prishtina - Llapi
Feronikeli - Drita
Liria - KEK-u

TABELA

| | | PIKË |
|---|---|---|
| 1. Feronikeli | 30 | 71 |
| 2. Llapi | 30 | 69 |
| 3. Prishtina | 30 | 69 |
| 4. Drita | 30 | 48 |
| 5. Ferizaj | 31 | 40 |
| 6. Drenica | 31 | 39 |
| 7. Ballkani | 31 | 39 |
| 8. Trepça '89 | 31 | 39 |
| 9. Flamurtari | 31 | 39 |
| 10. Gjilani | 31 | 35 |
| 11. Liria | 30 | 25 |
| 12. KEK-u | 30 | 1 |

### LIGA E PARË

Drenasi - 2 Korriku
Arbëria - Trepça
Onix - Istogu
Vëllaznimi - Besa
Dukagjini - Vushtrria
Ramiz Sadiku - Bashkimi (K)
Fushë Kosova - Vllaznia
Kika - Vitia

Tabela

| | | PIKË |
|---|---|---|
| 1. Vushtrria | 27 | 63 |
| 2. Dukagjini | 27 | 56 |
| 3. Besa | 27 | 55 |
| 4. Vëllaznimi | 27 | 51 |
| 5. Vitia | 27 | 47 |
| 6. Onix | 27 | 37 |
| 7. Trepça | 27 | 34 |
| 8. Arbëria | 27 | 33 |
| 9. Istogu | 27 | 32 |
| 10. 2 Korriku | 27 | 32 |
| 11. Fushë Kosova | 27 | 31 |
| 12. Drenasi | 27 | 29 |

# Besa sot përballet me Vëllaznimin në 'play-off'



PRISHTINË, 10 MAJ - Pas përfundimit interesant të stinorit në Superligën A për hendbollistë, ka ardhur koha për ndeshjet e fazës përfundimtare të kampionatit, përkatësisht "play-off"-it. Të dy ndeshjet e para gjysmëfinale luhen sot (e shtunë). Besa Famgas e pret në Pejë skuadrën e Vëllaznimit nga ora 17:00. Kampionia aktual, Besa, e ka përfunduar stinorin e rregullt në vend të parë, ndërsa Vëllaznimi në vend të katërt. Besa vlerësohet favorit i madh në këtë gjysmëfinale. Gjysmëfinalja tjetër zhvillohet në mes të Kastriotit të Ferizajt dhe Prishtinës. Këto dy skuadra u takuan të dielën edhe në finale të Kupës, ndërsa në një ndeshje të fortë e dramatike fitore me një gol dallim shënoi Kastrioti. Ndeshja e parë e "play-off"-it në mes të Kastriotit e Prishtinës luhet të shtunën nga ora 19:00, në Ferizaj. Ndeshjet e dyta luhen në Gjakovë e Prishtinë, ndërsa ndeshjet e treta eventuale prapë në Pejë e Ferizaj. Skuadra që shënon dy fitore, apo një fitore e një barazim, kalon në finale.

## Shtatë klube licencohen për garat e UEFA-s

PRISHTINË, 10 MAJ - Komisioni i Shkallës së Parë për Licencimin e Klubeve për garat e UEFA-së, pas takimeve nga data 2 maj deri më 10 maj, ka shqyrtuar dokumentacionin e shtatë e klubeve që kanë aplikuar për procesin e licencimit për garat e UEFA-s për edicioni 2019/2020. Komisioni në fjalë ka marrë vendim që t'ua japë licencat shtatë klubeve si në vijim: KF Feronikeli, FC Prishtina, FC Llapi, KF Drita, KF Trepça '89, KF Ballkani dhe KF Gjilani. Procesi i licencimit të klubeve për garat e UEFA-s për edicionin 2019/2020 ka filluar që nga 1 shkurti.



## Agim Agushi dhe Bujar Ajeti thyen rekordin 'Guinness'

Prishtinë, 10 maj - Zhonglerët Agim Agushi dhe Bujar Ajeti kanë thyer rekordin "Guinness" në disiplinën "Mbajtje e topit me kokë në çifte", duke arritur kohën prej 35 minutave. Gara e organizuar nga Fakulteti i Edukimit Fizik dhe Sportit në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina" dhe është mbajtur në kompleksin para Bibliotekës Kombëtare "Pjetër Bogdani". Ky rekord deri në vitin 2015 mbahej nga një çift suedez, e po në këtë vit rekordi u thye nga vetë Agim Agushi, duke arritur që në kohë prej 31 minutash të mbante topin me pasime në kokë në duet me Leutrim Agushin.



# 'Dardanët' dhurojnë 25 mijë euro për humanizëm



Prishtinë, 10 maj - Përfaqësuesja e Kosovës në futboll për një kohë të shkurtër pas daljes në arenën ndërkombëtare ka arritur t'i fitojë zemrat e të gjithë popullit dhe është bërë storie suksesi. Me djemtë "Dardanë" tashmë ndihen krenarë të gjithë. Ata janë shembull se si duhet përfaqësuar vendi dhe kombi, qoftë me paraqitjen e tyre në fushën e gjelbër, qoftë me kulturën e lartë sportive. Mirëpo, përveç talentit dhe vlerave të tyre në futboll, ata veçohen edhe për humanizëm të madh. Së fundmi, Përfaqësuesja e Kosovës ka ndarë 25 mijë euro për shoqatën humanitare "Jetimat e Ballkanit", donacion nga i cili një familje në nevojë do të bëhet me shtëpi të re, derisa do të shtrohet edhe një darkë për fëmijët jetimë. Ky donacion humanitar i djemve "Dardanë" ka ardhur me idenë e futbollistëve, e që është mbështetur edhe nga kryetari i Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi dhe i gjithë stafi i përfaqësues. Ky donacion njëherësh është shenjë falënderimi për mbështetjen e madhe që futbollistët kanë pasur nga i gjithë populli si në ndeshjet e Ligës së Kombeve, ashtu edhe në kualifikimet për "Euro 2020". "Grupi ynë i djelmoshave të Kombëtares dhe stafi, pasi u konsultuam me Presidentin Agim Ademi, vendosëm të ndajmë një shumë të të hollave për ta mbështetur ndërtimin e një shtëpie për një familje në nevojë nga shoqata 'Jetimat e Ballkanit' që udhëhiqet nga Halil Kastrati. Ne si futbollistë e kemi ndier si obligim moral që të kontribuojmë në këtë formë si falënderim të veçantë për grupin e tifozëve 'Dardanët' dhe të gjithë popullin e Kosovës për mbështetjen e palodhshme ndaj nesh. Pa mbështetjen e tyre ne nuk do të ishim kaq të suksesshëm dhe nuk do të ishim si një familje. Personalisht, falënderoj edhe të gjitha institucionet shtetërore që na japin mbështetjen e tyre dhe që po na bëjnë ëndrrat tona realitet", ka thënë Samir Ujkani, kapiten i Kosovës.

# Finalistët përcaktohen në ndeshjet e fundit

Toronto, 10 maj - Philadelphia fitoi 112-101 ndaj Torontos në gjysmëfinalen e gjashtë të "play-off"-it mes dy skuadrave në Konferencën e Lindjes, duke barazuar 3-3 serinë e takimeve. Çka do të thotë që emri i finalistit të dytë do të mësohet në ndeshjen e shtatë dhe të fundit. Fitore e lehtë e skuadrës së Philadelphias, që pati epërsi gjatë gjithë ndeshjes, duke u shkëputur deri në 20 pikë. Të pestë titullarët e Philadelphias realizuan mbi 10 pikë, duke qenë çelësi i këtij suksesi. Butleri me 25 pikë e Simmonsi me 21 ishin dy shënuesit më të mirë. Për ekipin kanadez u dallua Leonardo me 29 pikë e 12 rebounde, por i vetëm nuk pati asnjë shans t'i japë fitoren skuadrës së tij, raporton "Telesport". Në Perëndim, barazim 3-3 edhe në serinë e takimeve midis Portlandit dhe Denverit. Skuadra e Portlandit fitoi 119-108 në një ndeshje me dy pamje. Denveri ishte superior




në pjesën e parë, ku u dalluan Jokiqi me 29 pikë e Murray me 24. Gjithsesi, në periodën e fundit vjen përmbysja e Portlandit, që dominon në parket dhe triumfon falë 32 pikëve të Lillardit, 30 të McCollumit dhe 25 të Hoodit. Kjo është treshja e parë që realizon mbi 25 pikë secili në ndeshjet "play-off" që nga viti 2002.

| | | |
|---|---|---|
| **KONFERENCA E LINDJES - GJYSMËFINALE "PLAY-OFF"** | | |
| Milwaukee - Boston | | (4-1) |
| Toronto - Philadelphia | 101-112 | (3-3) |
| **KONFERENCA E PERËNDIMIT - GJYSMËFINALE "PLAY-OFF"** | | |
| Golden State - Houston | | (3-2) |
| Portland - Denver | 119-108 | (3-3) |

## SHKURT

### Klopp: Të gjithë prisnin finalen Barcelona - City

Trajneri i Liverpoolit, Jurgen Klopp, po ndihet krenar me suksesin e arritur me skuadrën angleze në Ligën e Kampionëve. "Reds" e humbën ndeshjen e parë nga Barcelona 3-0, kurse në ndeshjen e dytë arritën të fitojnë 4-0 dhe u kualifikuan në finale. "Të gjithë janë duke u marrë me ndeshjen ndaj Barcelonës. Më kanë ardhur miliona mesazhe për këtë ndeshje, po asnjë për atë ndeshje që kemi ndaj Wolvesit në kampionat. Duhet të përqendrohemi te kjo ndeshje, e cila në asnjë nuk e zvogëlon atë që kemi bërë ndaj Barcelonës. Sigurisht ishte një nga momentet më të bukura të historisë së futbollit, jo vetëm për Liverpulin. Tani le të përqendrohemi te ndeshja e radhës", ka thënë Klopp. Sipas tij, jo gjithmonë paratë sjellin suksesin. "Njerëzit flasin shumë për paratë, por nuk vlen vetëm ajo. Vetëm shikoni se si Tottenhami e kaloi verën e kaluar, pa blerë asnjë lojtar. Ne arritëm në finale se ishte dëshira jonë dhe e donim shumë atë. Të gjithë do ta prisnin finalen Barcelona - City", ka shtuar Klopp.

### Pensionohet Yaya Toure

Ish-mesfushori i Barcelonës dhe i Manchester Cityt, Yaya Toure, ka vendosur të tërhiqet nga futbolli. Lajmi është bërë me dije nga agjenti i lojtarit, Dimitri Seluk. Ish-mesfushori nga Bregu i Fildishtë do të përqendrohet në një karrierë si trajner. "Yaya Toure ka përfunduar karrierën duke luajtur. Tani ai do të përqendrohet në punën e trajnerit", ka deklaruar Seluk. Toure gjatë karrierës së tij ka veshur edhe fanellat edhe të Beverenit, Metalurh Donetskit, Monacos dhe Olympiacosit.

### Emery: Krenar me lojtarët dhe fansat

Trajneri i Arsenalit, Unai Emery, ndihet krenar me lojtarët e tij pas kualifikimit në finale të Ligës së Evropës. Arsenali e eliminoi Valencian në gjysmëfinale duke e mposhtur në të dyja ndeshjet me rezultat të përgjithshëm 7-3. "Jam shumë krenar me lojtarët e mi dhe fansat. Lojtarët bënë gjithçka që mundën dhe mund të jemi krenarë për gjithë klubin. Ishte shumë e vështirë të shënonim katër gola kundër këtij ekipi sepse është shumë i organizuar", ka thënë Emery.

### Rakitiqi, afër Interit

Skuadra e Barcelonës do të bëjë një revolucion të madh në afatin kalimtar të verës. Pas dështimit në Ligën e Kampionëve, ku për dy vjet radhazi janë eliminuar në mënyrë dramatike, spanjollët po mendojnë të rinovohen. Sipas asaj që raporton "El Mundo Deportivo", Interi dhe Barcelona kanë diskutuar marrëveshjen për Ivan Raikitiqin. Klubet nuk duan të humbasin kohë dhe një marrëveshje prej 50 milionë eurosh është pranë. Rakitiqi u përfol për një kalim tek Interi edhe në verën e shkuar, por vendosi të qëndronte për shkak të Ligës së Kampionëve. Në Barcelonë në verë do të mbërrijë De Jong dhe prioritet pritet të jetë holandezi.

### Sarri nuk rikthehet në Serinë A

Maurizio Sarri ka siguruar finalen e parë në karrierën e tij, atë të Ligës së Evropës, pas suksesit që arriti Chelsea ndaj Eintrachtit të Frankfurtit. Në finale tashmë do të jetë një derbi londinez me Arsenalin. Kjo arritje e ka kënaqur pa masë trajnerin italian, i cili është shprehur entuziast që karriera e tij është zhvendosur në Angli. Sarri e ka cilësuar futbollin në Premierë Ligën "të një niveli tjetër", një futboll që, "pavarësisht se luan shumë ndeshje në një sezon të vetëm, të jep adrenalinë". Kjo deklaratë, në njëfarë mënyre, mbyll dhe çdo diskutim për ta riparë Sarrin në Serinë A, madje vetë tekniku e pranoi se për momentin nuk do të kthehet.

Autor : GAZMEND MORINA

AKTORI AMERIKAN NË FOTO 1 (shqip.) | RADHITUR | GRADË USHTARAKE / YLL ME BISHT (sh.shq.) | FJALË TINGULLIMIT-UESE | SILIC | ZANORE | KËNGËTARJA ..... SUSURI | PËRMBLEDHJE E SISTEMUAR E NORMAVE JURIDIKE / KËNGËTARJA & AKTORJA AMERIKANE ..... ROSS | SHKËMB I MADH DHE I THEPISUR; THEP | OLIVIA MUNN | LËNDË PLASËSE QË PËRDORET NË LUFTË



1

MBURREM E SHES MEND; KAPARDISEM

SHTET NË EVROPË (pashq.)

NJERIU I PARË SIPAS FESË ISLAME / "KENIA"

VIDEO SPOT MUZIKOR / DY BASHKËTINGËLLORE

SHKRONJA XIX / MASË E VËLLIMIT TË LËNGJEVE (shq.)

KLUB FUTBOLLI NGA TIRANA / SHKRIMTAR I YNI

NOTË MUZIKORE / DISIPLINË SPORTIVE

PËREMËR VETOR

GOTË PREJ BAKRI / SHKRONJA XXIV

ANKESË / NIPPON TELEGRAPH TELEPHONE

NEVADA / RADIOLOKATORI

TË BUKURIT (shq.) / ZANORE

KRIPË E ACIDIT NITRIK (kim.) / "SUDANI"

LLOJ ËMBËLSIRE / LLOJ GËLQERORI

IRIDIUM, TON / DIKTATOR SOVJETIK

LLOJ ZOGU KËNGËTAR | KYÇ, NYJE | PENGESË PREJ DËRRASE QË NGRIHET SI MUR | INSTITUTO NACIONAL OFTALMOLOGY | TMERRI

DIREK I ÇATISË

PËRFUNDIM NË SHAH / INDIUM, AMPER

MJET PËR SKIJIM / U FRIKËSOVA

MIZOR; GJAKATAR / NJË E RESHUR

VENEZIA

KLUB FUTBOLLI AUSTRIAK / GJYQTARI SPORTIV

VEGËL MUZIKORE / VAZO LULESH

BIMË E VENDEVE TË NXEHTA

NJË PLANET NË SISTEMIN DIELLOR

ELEMENT KIMIK

OLIVER NEUVILLE / BASHKËTINGËLLORE

SKLLAV / FLOTA DETARE

PJESA ANËSORE QË DEL SI KRAH NGA TRUNGU I DRURËVE

FUTBOLLISTI SPANJOLL GONZALEZ / FINANCIAL SERVICES AUTHORITY

GJINI E LETËRSISË ARTISTIKE / 365 DITË

ZANORE / ATEMATIK, JO TEMOR

EPOKA E RE

FLORIDA, OHAJO / SHKRONJA TË NJËJTA

I TRILLUAR, I RREJSHËM / AKTORJA E VJETËR ... RINA

LLOJ QERREJE KUAJSH (sh.shq.) / MALAYSIA RUGBY UNION

ISH FUTBOLLISTI HOLANDEZ BERGKAMP

SANACION, PËRMIRËSIM / OJNAT

PASURIA E PATUNDSHME QË SILLTE TË ARDHURA / INSTITUCIONE

EMËR YNI MASHKULLI (shq.)

I MBARUAR, I SOSUR (krah.)

MJET UDHËTIMI (shq.) / NËPUNËSI MË I LARTË QEVERITAR NË PERANDORINË OSMANE

DY ZANORE / FUTBOLLISTI KROAT .... BUDAN

24 ORË

ZANORE

KATËR (romak) / KËNGËTARJA KANADEZE MORISSETTE

I NJËZËSHËM / ISLAM (perkdh.)

RILINDËSI VEQILHARXHI



2

KORIJE

TROYES / DJALI KUNDREJT PRINDËRVE TË VET

GDHIN / MBIEMRI I AKTORES ANGLEZE NË FOTO 2 (shqip.)

EMRI I AKTORES ANGLEZE NË FOTO 2 (shqip.)

SAHATI / MUZIKANTI KRASNIQI (shq.)

TAKSA

ENRIKE (shk.) / "D" pas dy "O"

ZANORE / FATKEQËSI E MADHE, KOB

EPOKA E RE

"NIRVANA" / KRAHINË NË SHQIPËRI

DETYRA E ROJTARIT / SHPREHI E KEQE

DY BASHKËTINGËLLORE / ZULMË

FEMËR E ZGJEDHUR NË NJË KONKURS BUKURIE

VEGËL MUZIKORE / *"LOS ANGELES"*

ENEDA TARIFA

LLOJ BIME KOKRRAT E SË CILËS PËRDOREN PËR USHQIM / TREVIS

BIMË BARISHTORE NJË VJEÇARE QË PËRDOREN PËR USHQIM / TOTENHAM

MUNDËSI, SHANS

VARGJET E PËRPUTHURA

ZGJIDHJA E FJALËKRYQIT: KREKOSEM, KOD, LETONI, ADEMI, DINAMO, KLIP, N, NDRE MJEDA, LA, TI, TAS, ANKIM, NITRAT, N, ARTI, SU, TORTA, IRT, TRA, PAT, SKI, KATIL, V, RIED, UTE, BANANE, URAN, ASTAT, ON, ROB, DEGA, RAUL, DRAMA, E, FO, FIKTIV, ARABAT, DENIS, SANIM, IRATI, DRITANI, TRENI, EA, DITA, A, IV, UNANIM, ZABEL, T, AGON, ELIZABET, ORA, TATIMI, ENR, U, NIR, ROJA, HM, MIS, VIOLINA, FASULE, DOMATE, T, RAST, RIMAT.

Shoqata Humanitare Bamirëse e Kosovës "Nëna Tereze"
The Kosova Humanitarian and Charitable Society "Mother Tereza"
Humanitarno Dobrotvorno Udruzenje Kosova "Majka Tereza"
10 000 Prishtinë Rr.ULPIANA U1/1 pn. Tel:00381 38 542 864, Fax: 542 869,
Web site: www.nenatereze.org e mail:ntereze@yahoo.com

# CONTRACT AWARD NOTICE

## *Supplies*

*According to Article 41 of Law No. 04/L-042 on Public Procurement of the Republic of Kosovo, amended and supplemented with the law No. 04/L-237, law No. 05/L-068 and law No.05/L-092*

**Date of the preparation of the Notice: 10/05/*2019***

| Procurement No | Equipment | 003 | 2019 | 121 |
|---|---|---|---|---|

This notice has been prepared in the LANGUAGES:

**English** ☒

**SECTION I: CONTRACTING AUTHORITY**

**I.1) NAME AND ADDRESS OF THE CONTRACTING AUTHORITY (CA)**

| | | |
|---|---|---|
| **Official name**: Kosovo Humanitarian Charitable Society " Mother Teresa" | | |
| **Postal address**: str. Mujë Krasniqi n.n. Ulpiana U1/1 | | |
| Town: *Prishtina* | Postal code: 10000 | Country: Kosovo |
| **Contact point(s)**: Zef Shala | | Telephone: 044-128-277 |
| Email: zefshala@hotmail.com | | Fax: 038-542-865 |
| Internet address (*if applicable)*: | | www.matherteresasociety.org |

**SECTION II: OBJECT OF THE CONTRACT**

**II.1) DESCRIPTION**

**II.1.1) Contract title attributed by the contracting authority:**
**Supplies with Bag Equipment for 40 Beneficiaries-Returnees**

**II.1.2) Type of contract and location of works, place of delivery or of performance**
*(Choose one category only - works, supplies or services - which corresponds to the main part of the specific object of your contract)*

| | | |
|---|---|---|
| | | ☒ **Supplies** |
| | | Main place of performance<br>All Kosovo according to the Request of Contracting Authorities |

**II.1.4) Short description of the object of the contract**
**Supplies with Bag Equipment for 40 Beneficiaries-Returnees**

**II.1.5) Common Procurement Vocabulary classification (CPV)**
**93.000.000.-8**

**II.1.6) Division into lots** YES ☒

**II.1.7) Estimated contract value: 40,000.00**

**SECTION III: PROCEDURE**

**III.1) TYPE OF PROCEDURE**

☐ **Open**

**III.2) AWARD CRITERIA**

☐ **Lowest price**

**III.3) ADMINISTRATIVE INFORMATION**

**SECTION IV: AWARD OF CONTRACT**

*(In case of some parts given to some successful economic operators, repeat S IV.4 and IV.5 for each lot)*

**IV.1) Date of contract award** 05/04/2019
**IV.2) Intended date of contract signing** 20/05/2019
**IV.3) Number of received tenders** 4
**IV.4) Name and addresses of economic operator to whom the contract has been awarded**

| | | |
|---|---|---|
| **Official name**: **General Supply and Logistics Sh.p.k.** | | |
| **Postal address**: 10000 Prishtinë | | |
| Town: *Prishtinë* | Postal code: 10000 | Country: Kosova |
| URL (*if applicable*): | | |
| **Contact point(s)**: Ilir Namani | | Email: generalsupplyandlogistics@gmail.com |
| Telephone: 045321797 | | Fax: |

**IV.5) Information on value of contract**

**Total final value of contract 42,000.00 Euro**

Responsive tender with lowest price: 42,000.00 Euro_
Responsive tender with highest price: 46,889.40 Euro_

**IV.6) The contract is likely to be subcontracted** No ☐

**SECTION V: COMPLEMENTARY INFORMATION**

**V.1) COMPLAINTS**

**Any interested party may file a complaint with the Contracting Authority according to article 108/A of the Law No. 04/L-042 on Public Procurement of the Republic of Kosovo, amended and supplemented with the law No. 04/L-237, law No. 05/L-068 and law No.05/L-092 , at the address specified in Section I of this Contract award notice.**

---

**Republika e Kosovës**
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government
**Shërbimi Spitalor Klinik dhe Universitar i Kosovës**
Univerzitetska Bolnička i Klinička Služba Kosova-Hospital and University Clinical Service of Kosovo
Qendra për Integrimin dhe Rehabilitimin e të Sëmurëve Kronik Psikiatrik - Shtime
The Centre for integration and rehabilitation of chronic psychiatric patients - Shtime
Centar za integrisanje i rehabilitaciju hroničnih psihijatrijskih bolesnika - Štimlje
**Sektori i Personelit**

Në bazë të nenit 8, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212; nenit 4 të Udhëzimit Administrativ (MPMS) nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik; nenit 6 parag. 1.1, nenit 10 të Statutit të Shërbimit Spitalor dhe Klinikë Universitar i Kosovës (SHSKUK);nenit 62 paragrafi 6 të Ligjit Nr. 04/L-125, për Shëndetësi; kërkesës nr.223 si dhe aprovimit te terkes me Nr 954 nga Drejtori i përgjithshëm i SHSKUK-se; Qendra për Integrimin dhe Rehabilitimin e të Sëmurëve Kronik Psikiatrik – Shtime, publikon:

## K O N K U R S

**I. Institucioni**: Qendra për Integrimin dhe Rehabilitimin e të Sëmurëve Kronik dhe Psikiatrik-Shtime

| | |
|---|---|
| **Pozita punës: Ndihmës mjekësor** | ( një pozitë ) |
| Koeficienti i pagës: | 5 |
| Orari i punës: | I plotë |
| Kohëzgjatja e kontratës: | Kohë të pacaktuar |
| Nr. i Referencës: | QIRSKPSH 03/2019 |

**Qëllimi kryesor i vendit të punës:**
Ofrimi i shërbimeve shëndetësore në kuptimin cilësor e sasior, bazuar në nivelin profesional që kërkohet për të gjithë profesionistët shëndetësor.

**Përshkrimi i punëve dhe fushat e përgjegjësisë për ndihmës mjekësor** :

- Përgatitja e pacientëve për mëngjes me nivel të lartë të higjienës personale
- Qëndrimi në kuzhine në mëngjes,drek dhe darkë deri sa ushqehen klientët
- Dërgimi i ushqimit me tase ne repart për klientët qe nuk ushqehen ne kuzhine ( pasi të ketë mbarur ushqimi për klientët tjerë që ushqehen në kuzhinë)
- Higjiena personale,pastrimi i klientëve,kujdesi për veshmbathjen,rregullimi i depos së veshmathjeve
- Dergimi dhe marrja e rrobave nga rrobalarje
- Për çdo ndryshim te gjendjes shëndetësore te klientit, lajmërohet infermieri i repartit
- Përgatitja e klientëve për gjumë nate(pastrimi i këmbëve- higjiene personale ne nivel)
- Gjate gjithë ndërrimit te natës pacientet duhet te jene nen mbikqyrje te vazhdueshme të ndihmësit mjekësor
- Për te gjitha punët dhe shërbimet e kryera ndihmësi mjekësor obligohet te mbaj shënime ne fletore te raportit te kujdestareve.
- Ndihmesat mjekësor raportojnë te infermierët
- Të marrë pjesë në mbledhjet e ekipit kur ajo është e nevojshme,
- Të kryejë edhe detyra tjera që kërkohen nga mbikëqyrësi për të siguruar efikasitet të lartë në punë.

**I. Dokumentet e kërkuara – fotokopje :**

- **D**iploma e Shkollës së Mesme
- Dëshmi se nuk është nën hetime
- **C**ertifikata nga libri amzë i të lindurve,
- **L**etërnjoftimi – fotokopje,
- **N**johja e kompjuterit (Word dhe Exel) – e dëshirueshme,
- **M**und të sillni edhe dëshmi tjera të aftësimit, rekomandime specifike, etj.

**Dokumentacioni i bashkangjitur këtij aplikimi nuk kthehet.**
Origjinalin e këtyre dokumenteve ose të vërtetuara të noteri do të kërkohet vetëm atëherë kur kandidati thirret për punë.
- Përvoja e punës do të këtë përparësi.

**Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim:**

-Të drejtë aplikimi kanë të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, kanë mbaruar shkollimin e kërkuar dhe kanë aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave sipas këtij konkursi.

**Procedurat e konkurrimit:** Konkurrimi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar. **Konkursi është i shpallur 15 ditë nga dita e publikimit në mjetet e informimit**

Në testim do të ftohen vetëm kandidatët që kanë plotësuar kriteret e konkursit. Kandidatët që i plotësojnë kriterët e konkursit do t'i nënshtrohen testit me shkrim, dhe të gjithë kandidatët të cilët nuk e kalojn testin me shkrim mbi 50% do të diskualifikohen automatikisht. Ndërsa të gjithë kandidatët që ju kanë nënshtruar testit me shkrim, dhe kanë arritur të kalojnë atë 50% e më shumë të pikëve të tij, do të ftohen në intervistën me gojë, pranë komisionit përzgjedhës. Renditja e kandidatëve do të bëhet sipas pikëve të përgjithshme që do të fitoj çdo kandidatë nga dy proceset si më sipër (testimi me shkrim dhe intervista me gojë).

**Paraqitja e kërkesave:** Aplikacionet merren dhe dorëzohen në zyrën e Sektorit të Personelit në QIRSKP-Shtime. Në aplikacion duhet të cekët qartë titulli i vendit të punës dhe numri i referencës.

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit dhe kërkesat e pakompletuara nuk do të pranohen.

Shtime, dt.10.05.2019

Drejtori i QIRSKP-Shtime

_______________________

Dr.Miftar Zenelaj

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**
**Qeveria – Vlada – Government**

Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës ( SHSKUK )
Univerzitetska Bolnicka i Klinicka Sluzba Kosova ( UBKSK )
Hospital and University Clinical Service of Kosovo ( HUCSK )

Spitali Përgjithshëm Ferizaj( SPF ) - Opsta Bolnica Urosevac(OBU) - Hospital General Ferizaj (HGF )

Drejtoria e spitalit përgjithshëm të Ferizajt, bazuar në nenin 8 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, dhe neni 4 i Udhëzimit Administrativ (MPMS) nr.07/2017 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik, si dhe neni 5 i Rregullores Nr.1003/2016 mbi marrëdhënien e Punës të SHSKUK-së.Drejtori Ekzekutiv me datë 08.05.2019 shpallë këtë:

## K O N K U R S

| | |
|---|---|
| **Institucioni :** | Spitali Pergjithshem Ferizaj |
| **Titulli i vendit të punës:** | Mjekë Specialist nga lëmitë përkatëse si më poshtë |
| **Kategoria funksionale/koeficienti:** | H-659 |
| **Nëpunësi mbikëqyrës:** | Shefi i repartit |
| **Kohëzgjatja:** | Për kohë të pacaktuar |
| **Numri referencës:** | 411/19 |

- Specialist pediatër, një (1)
- Specialist kardiolog, dy (2)

**Qëllimi kryesor i vendit të punës:**
Ofrimi i shërbimeve shëndetësore në kuptimin cilësor e sasior bazuar në nivelin profesional që ka

**Përgjegjësit kryesore të mjekut specialist:**

- Bashkë me Shefin e repartit dhe stafin tjetër drejtues menaxhon me resurset humane, paisjet, objektet e inventarin për nivelin te cilit i takon.
- Siguron standarde të larta të përkujdesjes ndaj pacienteve.
- Mirësjellja, kujdesi dhe respektimi i pacientit dhe personelit punues.
- Mirësjellja dhe bashkëpunimi profesional me stafin tjetër punues.
- Pranimi, ekzaminimi e trajtimi përkatës i pacientit.
- Kryen evidentimin e rregullt përmes dokumentacionit mjekësor (historia e sëmundjes, fletlëshimi, protokolli etj) të pacientit.
- Kryen vizitat e rregullta tek pacientët e shtrirë në institucionin shëndetësor.
- Bënë kërkesa për vizita plotësuese-konsultative,
- Mbikëqyrë realizimin e detyrave ditorë të punës të stafit punues.
- Jep mendime profesionale për punën që e kryen.
- Kryen detyra të tjera ashtu si kërkon mbikëqyrësi për mbarëvajtjen e punëve në institucionin ku është i punësuar.
- Kryen edhe detyra te veçanta kur i kërkohen lidhur me profesionin e ngushtë specialistik që e ka.
- Është përgjegjës për hartimin e plan-programit të punës së tij individuale e kolektive në vendin e punës,
- Angazhon stafin punues në realizimin e detyrave ditore të punës,
- Siguron dhe zhvillon programe e kurse trajnimi profesional,
- Bën kontrollin e rregullt (inspektimin e hapësirave, pajisjeve dhe të inventarit në vendin e punës).
- Siguron ambient të pastër e të sigurt për të gjithë,
- Menaxhon me material shpenzues dhe pajisjet tjera,
- Siguron sistem efikas komunikimi për të gjithë brenda institucionit,
- Përpunon dhe realizon protokole profesionale të trajtimit të pacienteve,
- Merr pjesë në studime kërkimore-shkencore profesionale,
- Ndërmerr masa për ngritjen e cilësive menaxhuese të aftësimit profesional dhe kolektiv në repart(njësi),
- Ushtron detyra plotësuese bazuar në kualifikimin e tij profesional dhe menaxhuese etj,
- Ofrimi i shërbimeve shëndetësore në kuptimin cilësor bazuar në nivelin profesional që ka,
- Dhënia e këshillave profesionale me shkrim e me gojë rreth trajtimit të pacientit dhe përcaktimit të terapisë ditore,
- Përcakton radhën dhe planin e ekzaminimeve klinike-laboratorike,
- Sipas radhës punë në ambulancën për pacientët jashtëspitalor dhe bënë ekzaminimin-pranimin e tyre.

**Kualifikimi, përvoja, aftësitë dhe karakteristikat personale, bazuar në specifikat e institucionit :**

- Diploma e Fakultetit të Mjekësisë;
- Licenca e Specialistit të lemisë përkatëse;
- Letërnjoftimi fotokopje;
- Përparësi do të kenë kandidatët të cilët kanë trajnime të veçanta, si dhe njohuri te mira të funksionimit të sistemit shëndetësor të Kosovës;
- Të ketë shkathtësi të dëshmuara dhe efektive të komunikimit me shkrim dhe me gojë, të ketë njohuri të gjuhëve zyrtare në përdorim;
- Njohja e punës me kompjuter është e domosdoshme ndërsa njohja e gjuhës angleze është përparësi;

**Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim:** Të drejtë aplikimi kanë të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore, të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, kanë mbaruar shkollimin adekuat, kanë aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave, dhe nuk janë të punësuar në sistemin publik shëndetësor.

**Procedurat e konkurrimit:** Konkurrimi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar.

**Data e mbylljes së konkursit:** 15 ditë nga data e publikimit në mjetet e informimit.

**Paraqitja e kërkesave:** Aplikacionet merren dhe dorëzohen në zyren e personelit te Spitalit Pergjithshem te Ferizajt, rruga" Ramadan Rexhepi" p.n.
Aplikacionet e dërguara pas datës së mbylljes së konkursit dhe kërkesat e pakompletuara nuk do të pranohen.

Drejtori Ekzekutiv

Dr.Jeton Zeqiri

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government
Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës ( SHSKUK )
Univerzitetska Bolnicka i Klinicka Sluzba Kosova ( UBKSK )
Hospital and University Clinical Service of Kosovo ( HUCSK )

Spitali Përgjithshëm Ferizaj( SPF ) - Opsta Bolnica Urosevac(OBU) - Hospital General Ferizaj (HGF )

Direkcija Opšte bolnice Uroševac, na osnovu člana 8 Zakona o radu Br.03 / L-212 i Odeljka 4 Administrativnog uputstva (MRSS) br. 07/2017 o regulisanju procedura javnog konkursa i člana 1003/1016 o radnom odnosu SHSKUK, Dana 08.05.2019.

## KONKURS

| | |
|---|---|
| **Institucija**: | Opšta bolnica Uroševac |
| **Naziv posla:** | Specijalistički lekari u sledećim oblastima |
| **Funkcionalna kategorija / koeficijent:** | H-659 |
| **Nadzorni službenik:** | šef jedinice |
| **Trajanje:** | Neograničeno |
| **Referentni broj:** | 411/19 |

pedijatrijska specijalnost, jedna (1)
Kardiolog specijalitet, dva (2)

Glavni cilj posla:
Pružanje zdravstvenih usluga u kvalitativnom i kvantitativnom smislu na osnovu profesionalnog nivoa

Glavni lekar:
• Zajedno sa šefom odeljenja i drugim rukovodećim osobljem, upravlja ljudskim resursima, opremom, inventarnim objektima na nivou na koji imaju pravo.
• Obezbeđuje visoke standarde brige o pacijentima.
• Ljubaznošću, brigom i poštovanjem prema pacijentu i radnom osoblju.
• Dobra volja i profesionalna saradnja sa drugim radnim osobljem.
• Prijem, pregled i odgovarajući tretman pacijenta.
• Vrši redovnu evidenciju kroz medicinsku dokumentaciju (povijest bolesti, letak, protokol i sl.) Pacijenta
Obavljati redovne posete pacijentima koji leže u zdravstvenoj ustanovi.
• Da podnesu zahteve za dodatne konsultativne posete,
• Nadgledati realizaciju svakodnevnih obaveza radnog osoblja.
• Dajte stručna mišljenja o poslu koji obavljate.
• Obavlja druge zadatke koje zahtijeva supervizor tražioca zaposlenja u instituciji u kojoj je zaposlen.
• On obavlja i posebne zadatke kada je to potrebno za svoju blisku specijalizovanu profesiju.
• Odgovoran je za izradu nastavnog plana i programa njegovog individualnog i kolektivnog rada na radnom mjestu,
• angažuje radno osoblje u obavljanju svakodnevnih dužnosti,
• Obezbeđuje i razvija programe i kurseve stručne obuke,
• Obavlja redovnu kontrolu (pregled prostorija, opreme i inventara na radnom mjestu).
• Obezbeđuje čisto i bezbedno okruženje za sve,
• Upravljanje potrošnim materijalima i drugom opremom,
• Obezbeđuje efikasan sistem komunikacije za sve u okviru institucije,
• Razviti i implementirati profesionalne protokole tretmana pacijenata,
• Učestvuju u stručnim naučnim istraživanjima,
• Preduzeti mjere za povećanje menadžerskih kvaliteta stručne i kolektivne obuke u odjeljenjima (jedinicama),
• Obavlja dodatne obaveze na osnovu svoje profesionalne i menadžerske kvalifikacije, itd.,
• Pružanje zdravstvenih usluga u kvalitativnom smislu na osnovu profesionalnog nivoa,
• Pružanje profesionalnih usmenih i pisanih saveta o lečenju pacijenta i određivanju dnevne terapije,
• Određuje redosled i plan kliničko-laboratorijskih ispitivanja,
• U zavisnosti od rada u ambulanti za ambulante i njihovog pregleda-prihvatanja.
Kvalifikacija, iskustvo, vještine i osobne karakteristike, zasnovane na specifičnostima ustanove:

• Diploma Medicinskog fakulteta;
• Licenca Specijalista odgovarajuće kategorije;
• Prioritet će biti dat kandidatima koji imaju posebnu obuku i dobro poznavanje funkcionisanja kosovskog zdravstvenog sistema;
• Da imaju dokazane i efikasne pismene i usmene komunikacijske vještine kako bi znali službene jezike u upotrebi;
• Priznavanje rada na računaru je od suštinskog značaja, jer je priznavanje engleskog jezika prioritet;
• Fotokopija lične karte

Uslovi za učešće u zapošljavanju: Svi državljani Republike Kosovo odrasle dobi imaju pravo da se prijave, koji imaju punu sposobnost da djeluju, imaju završenu adekvatnu edukaciju, imaju profesionalnu sposobnost da obavljaju svoje dužnosti, i nisu zaposleni u zdravstveni sistem.

Procedure takmičenja: Takmičenje je otvoreno za sve zainteresovane kandidate.

Datum zatvaranja konkursa: 15 dana od dana objavljivanja u medijima.

Zahtev: Prijave se primaju i predaju u kancelariju osoblja Opšte bolnice Uroševac, ulica "Ramadan Rekhepi" str.
Prijave poslane nakon datuma zatvaranja takmičenja i nepotpuni zahtjevi neće biti prihvaćeni.

**Izvršni direktor**

**Dr. Jeton Zeqiri**

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, kompania "Alfa Trade" Sh.p.k. Klinë, e Poshtme në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, organizojnë:

## DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për piken e karburantëve në Çagllavicë.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 31.05.2019 në ora 09:00 në restorantin e kompanisë "Al Trade" (BAU Market) shpk në Qagllavicë, do të organizohet debat publik nga kompania "Alfa Trade" Sh.p.k. Klinë, e Poshtme, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për pikën e karburantit në Çagllavicë.
Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

## Njoftim

Njoftoj se unë Beqir Shala me ID:1004821510, nga Buroja, Skenderaj kam humbur certifikatën e biznesit me NRB:70064909 lëshuar nga institucionet e Republikës se Kosovës me emër te biznesit N.T.SH "Balli Trans" me seli ne Burojë, Skenderaj dhe te njëjtën e shpall te pavlefshme për te nxjerr certifikatën tjetër për te vazhduar me aktivitet afarist.

## Njoftim

Njoftoj se unë Ibush Kabashi me ID:1003010644, nga Polaci, Skenderaj kam humbur certifikatën e biznesit me NRB:80107048 lëshuar nga institucionet e Republikës se Kosovës me emër te biznesit N.T.SH "Foto Kabashi" me seli ne Skenderaj dhe te njëjtën e shpall te pavlefshme për te nxjerr certifikatën tjetër për te vazhduar me aktivitet afarist.







## >> SHPALLJE TË VOGLA <<

▶ Ermal Juniku shpall te pavlefshme dipllomen shmlt "11 Marsi " Prizren

▶ Valbona Bytyqi shpall te pavlefshme dipllomen shmlt "11 Marsi " Prizren

▶ Erzen Zoga shpall te pavlefshme dipllomen shme " Ymer Prizreni " Prizren

▶ Lauresa Dërmaku shpallë të pavlefshme diplomën e Kolegjit HEIMERER, Prishtinë.

▶ Bekim Hoti, student i fakultetit Juridik në Kolegjin "AAB", shpall të humbur ID kartelën e lëshuar nga fakulteti.

▶ Faik Hyseni shpall te pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Dëshmorët e Qyqavicës" Qirez.

▶ Ganimete Zejnullahu shpall te pavlefshme diplomën e shkollës se mesme teknike "Anton Çetta" Skenderaj.

▶ Arsim Geci shpall te pavlefshme diplomën e shkollës se mesme profesionale QKS Skenderaj.

▶ Endrit Gashi shpallë të pavlefshëm dëftesat e klasës së: 10, 11, 12, dhe diplomën e sh. m. "Loyola Gymnasyun" - Prizren.

▶ "EURO-COD" SH.P.K shpallë të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 71249697 si dhe nr. fis. 601590517.

▶ N.SH. "A&D Projekt" shpallë të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 70265294

▶ Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

▶ Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

▶ Shitet banesa në Lakërishte përballë Procredit Bankës, hyrja e parë kati i 9 banesa ka 50m2 me dokumentacion të rregullt, çmimi52 000€. Për info 044/672-439.

▶ Lëshohet me qira banesa në lakërishte afër Procredit bankës është e mobiluar 50m2 për një çift çmimi është 220€. Për irno 044/672-439.

▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

▶ Shes banesën hyrja e 7 mbi kurriz te banesat e gjelbërta përball shkollës "Xhemajl Mustafa" e rinovuar tërësisht. Banesa ka 82 metra katror. 3 dhoma, sallon, shpajz dhe ballkon + taras me shfrytëzim. Çmimi 75000 Euro me para te gatshme, por bej edhe ndërrim me banesë me të vogël në Prishtinë ose banesë më të madhe në Fushë Kosovë sipas marrëveshjes. Numri kontaktues: 044 672 439

▶ Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

▶ Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.


ROYAL CROWN
RC cola
ANNOUNCING THE 2017
QUALITY & SALES AWARDS
Quality & Sales Award Recipients
(Listed in alphabetical order)
★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
★ Embotelladaora Central S.A Paraguay, Quality
★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Qualtiy
★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales
RC cola
Columbus, Georgia, USA
RC cola
0.5L


MEKA
HALAL FOOD
pashtetë pule
gluten free
100 % mish pule
cilësi e garantuar
pa konservues